



STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

Programi studimor: Letërsi e sotme shqipe

Teza:

Pozita dhe fati i gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit

Kandidatja:

Lulzana Aliti

Mentori:

Prof. dr. Hamit Xhaferi

Tetovë, 2019

Ndalohet çdo kopjim, përshtatje, shfrytëzim, përdorje ose çdo formë tjetër pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

## **D e d i k i m**

Këtë punim ua kushtoj njerëzve të mi që më kanë qëndruar gjithmonë pranë, duke më dhënë përherë ngrohtësi, mbështetje dhe besim. Në veçanti u dedikohet prindërve të mi, duke iu detyruar për gjithçka në rrugëtimin tim të studimeve dhe të jetës në përgjithësi! Faleminderit për lumturinë që më keni bërë të ndaj me ju çdo ditë!

## Falënderime

Në përfundim të rrugës së nisur e ndiej të nevojshme të falenderoj të gjithë ata që më kanë qëndruar pranë, sidomos në muajt e fundit, për gjithë përkushtimin, ndihmën, nxitjen dhe inkurajimin. Me këtë frymë, udhërrëfyesi im u bë Prof. dr. Hamit Xhaferi. Mirënjohja ime është e gjitha deri në përfundimin e tezës. Falë një bashkëpunimi të ngushtë u bë e mundur që disa ide interesante të marrin formë dhe të gjejnë zbatim në brendësi të punimit. Gjatë gjithë punës sime me ju, prof. H. Xhaferi, arrita të njoh cilësi dhe anë të karakterit tuaj që realisht më kanë nxitur të punoj më fort si dashuria për punën, përkushtimi në angazhimet e marra përsipër, shumë energji pozitive, korrektesa, mendimi kritik si dhe dashamirësia për të më ndihmuar. Një ndjenjë respekti dhe nderimi ndaj të gjithë atyre që më ndihmuan duke më lënë në dispozicion të gjitha romanet e Nazmi Rrahmanit. Një ndjenjë respekti ndaj të gjithë atyre të cilët më përkrahën në realizimin e këtij itinerari të cilin e fillova lidhur me punimin e temës së vullnetit, duke u bërë çështje e bashkëpunimit ndërmjet vëdi me kolegët dhe koleget, të cilët i falenderoj përzemërsisht.

Faleminderit!

## P Ë R M B A J T J A

D e d i k i m.....	3
F a l ë n d e r i m e.....	4
H y r j e.....	6
1. L ë n d a e h u l u m t i m i t.....	12
2. Q ë l l i m e t e h u l u m t i m i t.....	15
3. H i p o t e z a t.....	18
4. M e t o d o l o g j i a e h u l u m t i m i t.....	19
5. R ë n d ë s i a e p u n i m i t.....	23
6. S t r u k t u r i m i i p u n i m i t.....	26
7. P o z i t a d h e f a t i i g r u a s n ë v e p r a t e N a z m i R r a h m a n i t.....	30
P ë r m b a j t j a.....	34
P ë r m b l e d h j e.....	67
S u m m a r y.....	69
A б с т р а к т.....	70
L i t e r a t u r a e s h f r y t ë z u a r.....	71
D e k l a r a t a e a u t o r ë s i s ë .....	74
V ë r t e t i m.....	75

## H Y R J E

Objekt shqyrtimi i tezës së masterit është “Pozita dhe fati i gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit” - në të cilën përfshihen po thuajse të gjitharomanet e këtij shkrimtari, duke mos lënë anësh edhe shkrimet kritike të studiuesve shqiptarë për veprat e tij, për t’u trajtuar si subjekt i ambicieve të ndryshme kërkimore e shkencore. Ky studim synon të ofrojë një konceptim të thellë , ku në qendër të një analize vihen tiparet themelore të veprave të këtij autori, siç janë: "Malësorja", "Pas vdekjes", “Tymi i votrës së fikur” 1969, “Toka e përgjakur", I-II, 1973, “Rruga e shtëpisë sime” 1978, etj. Veprat letrare të tij mund të studiohen si tërësi, apo veç e veç, me qasje të veçanta dhe prej perspektivave të ndryshme. Megjithatë tipi i romaneve që shkruan ky autor janë të veçanta, me një stil të vetin dhe me strukturim të rrëfimit ndryshe. Për të krijuar një bazë të qëndrueshme mbi këtë temë, ky punim ka qasje gjithëpërfshirëse dhe është i konceptuar në linjë me nevojat e identifikuar të temës dhe i ndërtuar për të nxjerrë përfundime të rëndësishme. Rruga e kërkimit na dikton të ndjekim modelin kronologjik të krijimtarisë së Nazmi Rrahmanit duke iu përshtatur zhvillimit dhe sprovave të saj letrare. Krahasimi, analiza tekstuale, intertekstuale dhe narracioni janë rrafshet që do të ndiqen në këtë punim.

Mënyrat e trillimit të romancierit duhet të vërehen si gjurmim të thirrjes së femrës apo një sërë stisjesh letrare të cilat rrahin riskun e femrës shqiptare në Kosovën e atëhershme. Pra, përmes këtij studimi monografik, shqyrtojmë mënyrën krijuese të romaneve të këtij autori dhe atë në disa pikëpamje dhe fusha. Përqasja, përimtimi i fjalëpërfjalshëm, intertekstualiteti dhe narrativja janë fushat të cilat do të gjurmohen gjithashtu në këtë studim. Veçori këto që janë thelbësore për artin letrar të Nazmi Rrahmanit të cilat njëkohësisht nxisin edhe synimin tonë të fushave studimore, prapëseprapë ne do të ndalemi kryesisht në disa syre veprimesh.

Duke qenë se autori provon strukturën e romaneve, ne do trajtojmë karakteristikat e veçanta si për kah teknika e krijimit, për afërsisht edhe për nga ideja e tyre, ndërsa në rrafshin e trajtimit të romaneve ndiqet metoda e

analizës përmbajtjesore. Format e fikSIONIT të Nazmi Rrahmanit mund të shihen si ndjekje e zërit të gruas dhe figura e tij krijon mundësi të shumta me një vister sajimesh letrare që trajtojnë fatin e gruas shqiptare. Figura e tij krijon mundësi të shumta për t'u trajtuar dhe hulumtuar, në nivele shumëdimensionale, me qasje të llojllojshme. Perspektiva e tij artistike konsiston në vlerat artistike që bartë vepra e tij, me mundësitë që krijon për bashkëveprim dhe format tjera artistike, duke përfshirë aspektet letrare dhe artistike, historike, sociale dhe politike, kontekstet kohore, idetë, mesazhet, fabulat dhe ngjarjet.

Në pjesën hyrëse jam përpjekur për të bërë një prezantim të zbërthyer dhe shkoqitur mbi vlerën dhe peshën e çështjes e cila ka qenë pa dyshim në epiqendër të shqyrtimit tim, respektivisht studimit duke i shtjelluar të gjitha arsyet të cilat më kanë inkurajuar si kandidate e masaterit, duke bërë seleksionimin e kësaj teze dhe rrahjen e saj si një çështjeje përcaktuese. Për mënyrën e të rrëfyerit ky autor zgjodhi të folmen e ambienteve kosovare për të dhënë ngjarjet e thjeshta të jetës së përditshme, duke dëshmuar përkushtimin e asaj që e njihte më së miri.

Nazmi Rrahmani është njëri ndër romancierët e denjë kosovarë dhe në mbarë letërsinë shqiptare i cili në krijimtarinë letrare në prozë i ka shoshitur dhe përpunuar subjektet të cilat rrjedhin prej vetë botës sonë kombëtare duke u orvatur për të qenë i vaçantë ndaj kësaj bote shqiptare të gjallë dhe organike. Romanet e tij mund të studiohen si tërësi, apo veç e veç, me qasje të veçanta dhe nga perspektivave të ndryshme. Perspektiva artistike konsiston në vlerat artistike që bartin në vetvete këta vepra. Si ithtar i realizmit klasik, ky krijues në veprat e tij e ka rimëkëmbur gjithashtu edhe dramën tonë artistike duke e reflektuar atë nga nënshtrimi i egër serb, duke nxjerrë në dritë një varg figurash nëpërmjetë të cilave do ta bëjë përshkrimin e heroit (heroinës) të cilët luftojnë për të ekzistuar edhe atëherë teksa këtyre u bëhet e padurueshme për të jetuar. Andaj krijimtaria artistike e letrare e tij ka shumë forma, dhe si e këtillë arti i fjalës, historisë dhe politikës është i thellë, kompleks dhe me një narrativ të jashtëzakonshëm.



Shikuar nga aspekti i kontekstit kohor kur janë shkruajtur apo të ngjarjeve të veprave të tij, vërehen qartë qëndrimet e Nazmi Rrahmanit përballë zhvillimeve politike serbe në Kosovë. Ky romancier për lexuesin ofron një përcaktim të përgjithshëm të botës dhe një shumëllojshmëri ideshë nëpërmjet të cilave narrativi përçon ngjarjen. Për këtë arsye në letërsinë tonë bashkëkohore N. Rrahmani është i veçantë dhe i jashtëzakonshëm. E veçanta është sepse zelli i tij për të shkruar bëri që ky të formohej duke evoluar si krijues dhe romancier për t'u dalluar nga vepra në vepër. E jashtëzakonshmja të N. Rrahmani është se ky i dha një zë të fuqishëm dhe këndvështrim të ri temës së tij letrare, të cilën e parapëlqeu nga fillimi duke e kultivuar vazhdimisht, sidomos figurën e gruas së fshatrave kosovare. Për të krijuar një bazë të qëndrueshme për këtë temë, ky punim ka qasje gjithëpërfshirëse dhe është i konceptuar në linjë me nevojat e identifikuara të temës dhe i ndërtuar për të nxjerrë përfundime të rëndësishme. Për të arritur të përfundimet e duhura, ky punim është i strukturuar në krerët kryesorë dhe pastaj i ndarë në pjesë më të vogla, të cilat, të gjitha së bashku, janë në shërbim të temës qëndrore të këtij studimi. Ky romancier e shtjellon temën mbi gruan në dimensione të ndryshme, duke e vështruar atë nga aspekti social dhe moral.

Si ithtar i realizmit klasik, krijuesi në veprat e tij e ka rimëkëmbur gjithashtu edhe dramën tonë artistike duke e reflektuar atë nga nënshtrimi i egër serb, për të nxjerrë në dritë një varg figurash përmes të

cilëve do ta bëjë përshkrimin e heroit (heroinës) të cilët luftojnë për të ekzistuar edhe atëherë teksa këryre u bëhet e padurueshme për të jetuar. Të këtillë janë protagonistët Hajria te "Malësorja", Haziri te "Pas vdekjes", Gëzimi te "Rruga e shtëpisë sime", të cilët ballafaqohen me gjendjen e rëndë dramarike që e kishte kurdisur sundimtari djallëzor serb. Dekadat e paraluftës dhe pasluftës së dytë botërore shënojnë një të kaluar të tmerrshme duke e sprovuar të papërshkrueshmen në rrethanat historike dhe politike, duke ndikuar thellë tek popullata kosovare, por edhe tek poetët, prozatorët si rezultat edhe në vetë funksionimin dhe vlerën e artit që krijohet në Kosovë. Bie fjala, baresha Hajria te vepra "Malësorja" bie viktimë e pikëpamjeve reaksionare të cilat i ka synuar pushtuesi i egër serb i cili në realitet në faqet e kësaj vepre na del si djallëzori kryesor. Në këto rrethana dhe në këtë ambient të kthyer me kokën poshtë, duke i lexuar romanet e këtij shkrimtari, gjithmon në koshiencën tonë shtrohet pyetja se çfarë mund të ketë qenë roli i shkrimtarëve kosovarë? Apo si do të duhej një shkrimtar t'i përgjigjej shpërnguljes me dhunë, varfërisë dhe urisë së skajshme, në kohën e paraluftës dhe pasluftës, realitetin e hidhur dhe tjetërsimin e individit në aspektin fizik e moral që lidhet me varfërinë dhe mungesën e lirisë.

Kjo periudhë kohore në kuptimin më të gjerë, në letërsi solli frymën e zhgënjimit. Ka qenë një periudhë dëshpërimi e cila solli mjerim dhe shumë probleme shoqërore, morale dhe politike, të cilat në veprat romanore të këtij romancierit karakterizohen me mospajtim dhe

revoltë. Vëmendje e veçantë i kushtohet rëndësisë dhe ndikimit të veprave të tij në kontekstin politik, social e artistik dhe çfarë mesazhesh japin, njëkohësisht, çfarë vlerash artistike përmbajnë në vete e tjerë.

Atëherë, ndryshimi ndërmjet njërit karakter të veprës letrare në porozën e romancierit apo llojit të kundërt janë në kuadër të ecurisë ngjizëse, ndërsa si dëgjuesë ose ndjenjë e autorit në funksionin e mjeshtërisë artistike ndaj jetës dhe influencimit të tij ndaj natyrës njerëzore apo njeriut të ditur, i cili gjykon në mënyrë të thelluar dhe me urtësinë e të ndodhurit ose jetesës. Përmbajtja e tregimit na duket e trajtësuar duke përfshirë aspektet letrare, artistike, historike, sociale, politike, kontekstet kohore, idetë dhe mesazhet, duke qëndruar si e këtillë në mbarë krijimtarinë letrare të Nazmi Rrahmanit. Andaj, pikësynimi ynë është që në një mënyrë t'i vështrojmë romanet e këtij krijuesi në sistem dhe në të njëjtën kohë t'i lexojmë si një vlerë e kohës por edhe më gjërë, si motiv i yni i përhershëm. Duke iu referuar shpalimit të botës shpirtërore të grave, zakoneve, traditave dhe mjedisit kosovar e mbi të gjitha ligjërimin artistik.

Është e rëndësishme të theksohet se romanet e këtij autori mund të lexohen edhe jashtë kontekstit historik ose politik për atsyse se një gjë të tillë edhe ky studim i yni e dëshmon.

## 1. Lënda e hulumtimit

Domethënia e këtij shqyrtimi gjurmues dhe dituror ka si objekt analize letrare pozitën dhe fatin e gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit. Lidhur me këtë hulumtim do të merren parasysh hipotezat e mëposhtme që kanë të bëjnë me një lidhje të ngushtë midis veprave të Nazmi Rrahmanit, ku në plan të parë ndeshim personazhin kryesor të femrës apo të burrit, të cilët në veprat tjera mund të jenë njëri nga këta si personazh dytësor. Rruga e hulumtimit na dikton të ndjekim modelin kronologjik të krijimtarisë së këtij autori duke iu përshtatur zhvillimit dhe sprovave të tij si romancier. Krahasimi, analiza tekstuale, intertekstuale dhe narracioni janë rrafshet që do të ndiqen në këtë studim. Megjithatë tipi i romaneve që shkruan Nazmi Rrahmani është i veçantë, me një stil të vetin e me strukturim të rrëfimit ndryshe. Lidhur me këtë hulumtim do të merren parasysh hipotezat e mëposhtme që kanë të bëjnë me një lidhje të ngushtë midis veprave të Nazmi Rrahmanit, ku në plan të parë ndeshim personazhin kryesor të femrës apo të burrit, të cilët në veprat tjera mund të jenë njëri nga këta si personazh dytësor. Romani "Malësorja" është vepër prozaike e cila trajton fatin e një malësoreje dhe ngërthen në vete një motiv mjaftë tërheqës i cili zanafillën e ka nga jeta bashkëkohëse në fshatin shqiptar në Kosovë. Është një shfaqje e rremtuar që flet për jetën e heroinës kryesore, bareshës Hairije e cila mëkëmbet duke u hijeshuar gjithnjë e më shumë.

Pra, është një rrëfenjë me një mori mbartësish të ndryshëm që zanafillën e saj e ka nga ndodhitë të cilat bashkërisht krijojnë pamjen e vërtetë të një ambienti tipik kosovar ndërmjet dy luftërave botërore.

Nazmi Rrahmani rrëfen në një kuptim të zakonshëm por mjaft të mirëfilltë mbi gjindjen e mjedisit të tij, të përmendur, veçanërisht lidhur me argëtimet dhe dëshpërimet e tyre, prirjet dhe forcat e brendshme dhe tiparet, shqetësimet dhe mangësitë e tyre, njësoj sikurse i kishte dëgjuar si vogëlush për së afërmi në burimin e gjallimit në fshat. E gjithë kjo duket se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes figurave pozitive dhe atyre negative, qofshin këto femra apo meshkuj. Ndër të tjera vërejmë se te disa vepra shkrimtari zbulon aspekte kompozicionale dhe krijuese të punës dhe jetës së tyre që mund të aplikohen në veprat në fjalë. Pra, rreh riskun e një malësoreje që trajton një ndodhi e cila paraqet fatin e hidhur dhe tronditës të një malësoreje e cila përjeton një tentim përdhunimi nga dy të rinj. Shkrimtari nëpërmjet të këtij romani krijon një botë të caktuar, ndërsa nëpërmjet të rreshtave dhe ngjarjeve që zhvillohen, ai e nxjerr lexuesin nga monotonia e jetës së përditshme dhe e futë atë në botën e romanit, për arsye se humbet në imagjinatën e krijimtarisë së autorit.

Romani është shkruar mjeshtërisht dhe ngërthen në vete një varg harmonik mjaft tërheqës i cili zanafillën e ka nga jeta bashkëkohëse në fshatin shqiptar në Kosovë. Është një shfaqje e rremtuar që flet për jetën e heroinës kryesore, bareshës Hairije e cila mëkëmbet duke u hijeshuar

gjithnjë e më shumë. Pra, është një rrëfenjë me një mori mbartësish të ndryshëm që zanafillën e saj e ka nga ndodhitë të cilat bashkërisht krijojnë pamjen e vërtetë të një ambienti tipik kosovar ndërmjet dy luftërave botërore.

Nazmi Rrahmani rrëfen në një kuptim të zakonshëm por mjaft të mirëfilltë mbi gjindjen e mjedisit të tij, të përmendur, veçanërisht lidhur me argëtimet dhe dëshpërimet e tyre, prirjet dhe forcat e brendshme dhe tiparet, shqetësimet dhe mangësitë e tyre, njësoj sikurse i kishte dëgjuar si vogëlush për së afërmi në burimin e gjallimit në fshat. E gjithë kjo duket se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes figurave pozitive dhe atyre negative, qofshin këto femra apo meshkuj. Format e fikSIONIT të këtij autori mund të shihen si ndjekje e zërit të gruas dhe një vistër sajimesh letrare që trajtojnë fatin e gruas shqiptare. Ndër të tjera vërejmë se te disa vepra shkrimtari zbulon aspekte kompozicionale dhe krijuese të punës dhe jetës së tyre që mund të aplikohen në veprat në fjalë.

## 2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi ynë ka qenë që të hulumtoj më për së afërmi fushën e letërsisë, përkatësisht romanet e shkrimtarit Nazmi Rrahmanit, andaj ky hulumtim do të kontribuojë në njohjen e letërsisë tonë. Konsideroj se ky hulumtim i magistraturës, do të jetë një kontribut i mirëfilltë shkencor për artin, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Hulumtimi ynë lidhur me këtë tematikë ka një peshë të veçantë, për arsye se përmes kësaj ne kemi pasur për qëllim të pasqyrojmë figurën e gruas dhe të burrit në rolin e një shëmbëlltyre me peshë të veçantë që vepron në rrethin e ngushtë shoqëror kosovar të cilët lozin një funksion madje të mirë ose të keq gjatë tërë poreve të gjëllimit. Në veprat e këtij romancierit gratë dhe burrat shfaqen me novacionet e tyre interesante dhe të veçanta.

Pikësynimi ynë ndaj këtij studimi mbështetet në pikëzimin dhe ndikimin e këtyre tek lexuesit, veçanërisht forcimin e ndërgjegjes dhe lartësimin ndërmjet gruas dhe burrit, veçanërisht shquarjes së figurës së gruas dhe burrit e sidomos dinjitetin të cilin e kanë këta në krijimet e këtij romancierit. GRëndësia e gruas dhe burrit në romanet e këtij autori shfaqen në mjaft dimensione, duke u nisur prej rolit që kanë ata gjatë jetës së zakonshme, të cilët duken sikurse një gërshetim i individualiteteve dhe kohës, vërtetësisë dhe përfytyrimit, element ky i cili shfaqet në veprimtarinë e këtij romancierit. Gërshetimin e

protagonistes grua dhe burrë dhe kohën në të cilën këta operojnë, Nazmi Rrahmani e ka vrojtuar në mënyrë dinjitoze, duke e lartësuar figurën e këtyre si mjaft të veçantë, gjë e cila dëshmon në të gjitha romanet e këtij krijuesi. Femra për këtë krijues është një krijesë e dashur, ndonëse ka herë e paarritshme. Ky krijues lidhur me gruan krijon mjaft epitete të bukura, gjë e cila nuk rrjedh sikurse një shfaqje e ndonjë ndjenje, veçse si një sprovë e çiltër dhe njëherësh morale. Ai rrëfen në mënyrë mjaft të kuptueshme dhe të rrjedhshme sepse me bashkëshorten lypset me qenë i kënaqur edhe nëse tek kjo vërejmë ndonjë të metë. Për këtë arsye këtë lypset lënë mënjanë, meqenëse nuk gjendet në botë ndonjë grua apo burrë i përkryer. Pikërisht, romancieri orvatet të vë në pah, gjendjen e femrës, për arsye se kjo e ka hallin e saj për të qenë e pëlqyer me tërë botën e vet, me tërë bukurinë, të metën, forcën dhe dobësitë të cilat mund t'i ketë. Jam e bindur se ky punim shkencor do të ndikoj në ngritjen time intelektuale dhe profesionale, në të mirë të letërsisë, artit dhe kulturës shqiptare.

Gjithë ky përkushtim i yni tregon qartë për vlerën dhe peshën e këtij gjurmimi dhe përshkrimi të N. Rrahmanit. Me anë të këtyre romaneve, na jep rastin që të vrojtojmë dhe njohim prej rrethit të ngushtë procesin psikik të heroinës kryesore femër dhe mashkullit, ka herë duke zbardhur edhe emocionet e fshehta të këtyre. Autori pa dyshim i shfaq hijshëm tiparet e shumëllojshme të cilët i kanë vashat, gratë dhe burrat,



që me këto cilësi mbartin një larmi ngjyrimesh jetike, të ndijimit dhe formimit shpirtëror të këtyre. Përmes këtyre veçantive ky romancier na jep një pamje të hapur të gjithësisë së gruas dhe burrit. Kësisoj ky orvatet me mjeshtëri të rrallë të zbulojë figurat e këtyre njësoj sikurse librat kur janë të hapura ndaj lexuesit, në të cilat përshkruhen botërat e këtyre. Andaj tek veprat e këtij krijuesi, gratë dhe burrat mund ta shohin vetveten e tyre në funksione apo detyrime morale në bashkimin e organizuar kombëtar. Në këtë mënyrë, veprat e këtij romancieri janë mjaft aktuale, për arsye se në këto bëhet fjalë haptas mbi çështjet intime morale, ndjeshmërinë e këtyre, naivitetin dhe çiltërinë, duke e shfaqur një botë të vërtetë ku ata jetojnë dhe operojnë në një kohë të vështirë të sundimit serb.

### **3. Hipotezat**

Lidhur me këtë hulumtim do të merren parasysh hipotezat e mëposhtme që kanë një lidhje të ngushtë midis veprave të Nazmi Rrahmanit, ku në plan të parë ndeshim personazhin kryesor të femrës ose të burrit, të cilët në veprat tjera mund të jenë njëri nga këta edhe personazh dytësor.

Në romanet e këtij autori ndeshim një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet figurave pozitive dhe atyre negative, madje pa marrë parasysh qofshin këta gra ose burra. Tek disa vepra të Nazmi Rrahmanit vërejmë ndërmjet tjerash se ky romancier orvatet të zbulojë disa nga aspektet kompozicionale dhe krijuese të punës dhe jetës së tyre të cilat mund të aplikohen njëkohësisht edhe në veprat në fjalë.

#### 4. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë këtij hulumtimi studimor do shfrytëzohet metodologjia më përkatëse dhe bashkëkohore që i përshtatet subjektit, me synimin e vetëm për të arritur gjer te njohuritë të cilat i konsiderojmë si objektivin kryesor të cilat duhen arritur, për arsye se shfrytëzimi i duhur i metodave gjatë hulumtimit ndikojnë në gërshetimin dhe shtjellimin e vërtetë të këtij studimi letrar. Për të realizuar këtë temë jemi ndalur në disa metoda, andaj hulumtimi ynë do të realizohet përmes sendërtimit analitik të kritikës tekstuale dhe krahasimeve letrare, estetike dhe gjuhësore. Është përdorur metoda krahasuese, përshkruese dhe analitike. Metoda analitike që përshkon punimin na ka ndihmuar që nëpërmjet analizave të hollësishme të paraqesim të gjithë problematikën që shoqëron ligjërimin mashkullor dhe femëror. Gjithashtu, është përdorur analiza e tekstit për të treguar ndryshimet gjinore në ligjërim, si edhe për të bërë dallimin mes gjuhës së meshkujve dhe femrave. Metoda e analizës dhe sintezës do të përcaktojë një përgjithësim të çështjes së marrë në shqyrtim, duke kaluar nga kuptimet e veçanta, në kuptim përgjithësues të artit letrar. Nëpërmjet kësaj metode do të kërkohet të arrijmë në vlerësimin që dukuritë dhe lidhjet e tipareve, elementeve dhe veçorive letrare, ndjehen në këtë roman.

Kjo metodë do të mbështetet në një nocion kryesor, “E gjithë letërsia është artistike”, që do rezultojë e pranishme në pjesën më të

madhe të punimit. Në bazë të vrojtimeve të ndara, të veçanta, do të nxirren përfundimet e përgjithshme, të ilustruara megjithatë përmes shembujve të marrë nën shqyrtim në zbardhjen e çështjeve të caktuara.

- Një tjetër metodë e rëndësishme e cila do të gjejë zbatim, është metoda krahasuese ndërmjet artit letrar ndërmjet autorëve të veçantë shqiptarë dhe autorëve bashkëkohorë. Kjo do të realizohet qoftë në krahasimet teorike, mbi procesin krijues, qoftë duke depërtuar, analizuar dhe interpretuar romanin "Malësorja". Dukuritë letrare do të vështrohen, në radhë të parë nga pikëvështrimi ndërtekstor, duke i analizuar përbërësit themelorë të veprave letrare të Nazmi Rrahmanit, duke i vënë këto në përqasje me veprat e autorëve të tjerë, të cilët karakterizohen përgjithësisht nga përmbajtja fantastike e tekstit letrar.

Ky punim do të vlerësojë mënyrën narrative specifike, në brendinë e romaneve, të cilët ia vlejné të hetohen. Tematizohen motivet e vullnetit dhe arsyes me dëshirën dhe mundësinë gjatë thurjes së intrigës. Lexuesit presin ndryshim, që gjithçka duhet të ndodhë patjetër, e kjo nën projektimin e një mënyre letrare ku fjalët bëhen ngjarje që marrin jetë përtej të mundshmes dhe reales.

Teksti ndërtohet, përçon – komunikon dhe bën ndikimin estetik nëpërmjet mesazheve që dalin nga struktura e veçantë gjuhësore. Së këndejmi, kur flasim për artin letrar të këtij autori, i referohemi gjuhës dhe veçantisë së kumteve që jepen nëpërmjet saj.

Shumësia kuptimore që del nga leximi, veçanërisht llojit i përjetimit dhe interpretimit që ofrohen kjo vepër letrare.

Ky proces e nënkupton tekstin letrar, fillimin dhe mbarimin e tij, por edhe gjithë atë që gjendet midis këtyre dy pikave të skajshme të tërësisë së tij. Shndërrimi i jetës në tekst nuk është shpjegim, por inkuadrim i ndodhive (në rastin përkatës nacional) në kujtesën (mendimin) kolektiv.

Kuptimi letrar dhe artistik është lëvizje e përhershme midis gjuhës dhe tekstit dhe rrjetës së nëntekstit, që nuk janë në vepër, po janë thelborë për ta kuptuar atë.

Në këtë mënyrë letërsia artistike, më shumë se çdo lloj tjetër letërsie lexohet, receptohet ndryshe, prandaj edhe ndikimi i veçantë gjuhësor tek lexuesi e plotëson përfytyrimin e imagjinare. Ky punim mbështetet në një qasje metodologjike të kombinuar brenda traditës empirike të kërkimeve dhe studimeve letrare.

Në mënyrë të veçantë do të shfrytëzohen burimet përkatëse që janë në dispozicion gjatë studimit dhe shqyrtimit letrar të romaneve të Nazmi Rrahmanit, sikurse janë romanet: “Malësorja” 1965, “Pas vdekjes (Kthimi i njeriut të vdekur” 1975, “Tymi i votrës së fikur” 1969, “Toka e përgjakur”, I-II, 1973, “Rruga e shtëpisë sime” 1978, etj.

Gjithashtu janë marrë në konsideratë edhe shumë kompozime të ndryshme që kanë të bëjnë me korpusin e veprave të këtij shkrimtari, duke i komentuar këta nëpërmjet masës dhe thellësisë së ndryshimeve që ka ndërmarrë ky autor. Qëllimi i metodologjisë së hulumtimit është që të sigurojmë dëshmi të cilat do të testojnë dhe mbështesin, apo mohojnë hipotezat. Zbatimi i metodologjisë, sidomos asaj cilësore dhe analizës sasiore të hulumtimit letrar dhe artistik duke u zbatuar me përpikmëri në këtë mikrotezë.

## 5. Rëndësia e punimit

Rëndësia e këtij hulumtimit shtrihet në tërësinë e problematikave apo në tematikën e çështjeve të cilat shtrohen, pasqyrohen, studiohen dhe shqyrtohen në problematikën e larmishme dhe brendinë e cila ndërlihdhen me subjektin artistik apo me vlerën ideoartistike. Kjo tezë është orientuar në përvijimin e pikësnyimit personal të krijuesit dhe figurave kryesore të krijimeve letrare në prozë, tek të cilat Nazmi Rrahmani i ka dhënë burimet e tyre kryesore të cilat çuan në krijimin e dy tragjedive të mëdha të periudhës elizabetiane. Gjithashtu teza ka për qëllim të vë në spikamë zhvillimin e diferencave dhe synimeve të shëmbëllyrave relevante: në rastin e figurave të grave ose burrave që në disa pikëpamje veprojnë dhe gjëllojnë në një ambient të rëndomtë kosovar. Tendenca e Nazmi Rrahmanit ka qenë që t'i japë veprimtarisë letrare të tij një domethënie mendimtare, tek e cila synon dhe e gjen sqarimin e tij mbi fshehtësinë e jetës në mes të realitetit dhe fiksionit. Ky vegim i këtij autori do të jetë një analizë e qëllimeve, ku shfaqen ëndërrat e shpirtit të gruas dhe të burrit të cilat i kanë shëmbëllyer kohës e cila ka ecur sikurse anija gjatë jetës në këtë ambient. Pas një analize të plotë të faktorëve të përmendur më sipër, kjo punë kërkimore artistike ka lindur spontanisht nëpërmjet një informacioni më të detajuar dhe specifik në lidhje me krijimet letrare të cilat kanë për qëllim reflektimin e një rrethi shoqëror komunist me shumë vështirësi, mëdyshje dhe

fshehtësi. Romanet e Nazmi Rrahmanit spontanisht na duken se na japin njohuri për atë që është mënyra më e mirë për të kuptuar gruan si femër, bashkëshorte, zyrtare dhe me formim arsimor, por edhe bashkëshortin në pozitë e njëjta.

Në një gjendje të këtillë edhe dashuria nuk është një prag rrugëdaljeje, për arsye se ajo si e këtillë gjithashtu ka qenë si diçka ndërmjetme, e cila duket si një gotë me ujë e cila mjegullon. Ky studim synon të hapë lojën e gjetjes së impulsit jetësor të shkrimtarët shqiptarë. E pastra, e vërteta, e pandryshueshmja është e mundur vetëm përmes eksperimentit “magjik” të artit. E pastra, e vërteta, e pandryshueshmja është e mundur vetëm përmes eksperimentit “magjik” të artit. Vepra letrare "Malësorja" përngjan edhe si himn i vyer ndaj Jetës, ndaj rrahjeve tejkohore të ekzistencës sonë, që aq shpesh e harrojmë sa e bukur, e shkurtër, misterioze dhe fantastike ajo mund të jetë. Praktikisht, këto dy forma kanë një ngjashmëri dhe simetri të dukshme me njëra tjetrën, duke përfshirë në mes hapësira të një vijimësie që është e prekshme dhe ngjall emocione të përafërta tek lexuesit. Nëse përafrojmë kushtet historike ku merr formë universi letrar i Ismail Kadaresë në letërsinë shqipe, do të gjejmë ngjashmëri të prekshme brenda këtij konteksti.

Mesazhi është njëkohësisht i qartë për atë që e jep dhe për atë që e merr. Lexuesi di që po depërton brenda tekstit duke njohur kodin dhe mekanizmat e përdorur nga autori në krijimin dhe ndërtimin e tij. Bëhet fjalë për tekste ku shpesh lexuesi ia del pa vështirësi të zbërthejë një



simbolikë krijimi që e njeh mirë. Pra pakti autor-lexues është i qartë dhe i mirëkuptuar nga të dyja palët.

Mesazhi është i qartë për atë që e transmeton, por është i paqartë për atë që e merr. Kjo lloj situatë paraqitet në rastet e një vizionariteti kuptimplotë të autorit, kur arrin të shohë përtej kohës së tij dhe gjërat e qarta e të kuptueshme për të, kanë një sens dhe një thellësi interpretimi shumë herë më të madhe nga mundësia e lexuesit për t'u gjetur në të njëjtën anë leximi me të. Mesazhi është i errët për autorin, por mund të deshifrohet nga një lexues i informuar.

Ky lloj vizioni ka një nuancë pashpjegueshmërie, qoftë për krijuesin që kërkon të përkthejë përmes fjalës imazhet rreth tij, qoftë për lexuesin që kërkon t'i afrohet të vërtetës përmes fjalës. Mesazhi është i qartë për atë që e transmeton, por është i paqartë për atë që e merr. Mesazhi është i errët për autorin, por mund të deshifrohet nga një lexues i informuar. Mesazhi është njëkohësisht i errët për atë që e transmeton dhe për atë që e merr.

## 6. Strukturimi i punimit

Struktura e këtij punimi përbëhet nga parathënia, hyrja përfundimet, bibliografia dhe shtojcat. Duke yshtur vëmendjen e lëçitësve lypset ravizuar njëfarë ndërtimi të mirëfilltë të studimit, për këtë arsye nevojitet që ne si hulumtues të moshës së re të përthellohemi edhe më shumë në kuadër të aftësive që kemi, njëkohësisht duke përpiluar një studim me arritje të rëndësishme dhe të nevojshme. Për këtë arsye ky shqyrtim artistik pasqyron njëfarë veprimtarie sistemi dijesh dhe hulumtimesh të vërteta e të qarta në të cilat shtjellohen problematika me vlerë që janë të lidhura ngushtë me shëmbëlltyrën e personazheve të grave ose burrave në krijimet letrare të këtij romansieri. Prandaj shikuar nga ky këndvështrim konstatojmë se tiparet dalluese dhe me peshë të veçantë mbi secilin studim paraqesin ndërtimin strukturor të tyre.

Duke krijuar një ndërthurje të qartë, fillimisht në lidhje me subjektin lypset të kemi dituri të gjithanshme. Gjatë studimit të thukët të veprës së tij, konstatohet se veprën e tij letrare e ka të ndërtuar mbi baza të forta dramatike, si në aspektin e krijimit të fabulës, zhvillimit të ngjarjes, ndërtimit dhe rrjedhës së ngjarjeve të karaktereve të personazheve, gjuhës në këtë vepër dhe veprimeve të tyre. Andaj synimi ynë ka qenë për të vënë në pah figurën e gruas dhe burrit në romanet e

këtij romancieri. Heroi kryesor i zamanit dhe shtrirjes, është pjesë kryesore e mënyrave të rrëfimit në letërsinë shqipe.

Përfundimisht, nëpërmjet të këtij punimi synohet që të shtjellohet letërsia shqipe në një aspekt jo të zakonshëm të saj, në një dimension shumë pak të eksploruar, në lidhjen e saj me artin. Për këtë arsye ky protagonist është rëndom lajmëtari parësor i këtij krijuesi. Vërejmë se nëpërmjet kësaj përvijohet dhe shfaqet vetëdija individuale dhe ajo e përbashkët, nga të cilat shfaqet pikësynimi dhe e ardhmja jetike e njeriut kosovar. Teksa hero i kryesor lartësohet në plan përfaqësues, duke shfaqur qartë jo veçse vetëdijen e së kaluarës, mirëpo njëherazi e sinjalizon gjithashtu këtë vegim dhe ndijim i cili porsa kishte filluar të duket se kishte lindur në horizont. Nëpërmjet tij janë bërë edhe gjurmime të mjaft breznive.

Nazmi Rrahmanit është një krijues me peshë mjaft të veçantë që pa mëdyshje shpalos cilësitë dalluese të larta, për arsye se secili roman i këtij krijuesit paraqet njëfarë historie të veçantë ku çdo lexuesi i ka lënë mbresë dhe vëmendje të papërshkrueshme mbi veprimtarinë e Nazmi Rrahmanit. Romanet e tij janë të ndërthurur ndërmjet tyre për arsye se pasqyrojnë jetën e vërtetë. Mënyra këndvështruese në prozën e këtij krijuesi është mjaft e posaçme. Andaj nga ky shkak pa dyshim se krijuesi i kultivon cilësitë më të plota të realitetit të vërtetë. Atëherë, ai e tregon fatin e njerëzishëm dhe çështjet jetike. Duke elaboruar më shumë

çështje të cilat lidhen me letërsinë dhe me subjektin e këtij punimi. Fillimisht trajtohen zhvillimet dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar nëpër kohë popullata e malësisë shqiptare në Kosovë dhe duke i saktësuar specifikat e veçanta të saj.

Nazmi Rrahmani i përshkruan figurat e gruas dhe burrit si njërat ndër rrethanat mjaft domethënëse për rrethin shoqëror shqiptar të kohës. Femra dhe mashkulli janë figura të përkryera, për këtë arsye romancierit u ofron tërë të vërtetat të cilat ngjasojnë me tiparet dalluese të tyre. Me një fjalë, ai e mbështet figurën e gruas dhe të burrit duke u kushtuar vëmendje të veçantë duke i saktësuar specifikat e tyre. Për të vazhduar më tej me këtë temë, në mënyrë të qartë dhe të strukturuar. Lidhur me Nazmi Rrahmanin që të dy këta si botëra njerëzore mbartin vetitë e vërteta në rrethin shoqëror shqiptar. Për këtë arsye femrat dhe meshkujt i shpalos si iniciatorët kryesor të transformimit të përbashkët. Gratë në tërësi kanë qenë jo aq sa duhet pjesëmarrëse në postet ku gjendej mashkulli, porse kjo, megjithatë është lënë mënjanë nga kjo pikëpamje, prapëseprapë pak nga pak nisi t'i realizojë funksionet e imagjinuara të saj, pa marrë parasysh kushtet në të cilat kanë jetuar. Në linjë me rrjedhën logjike, vend të veçantë zë gruaja e cila ëndërron sërish dhe në pjesën më të madhe të çështjeve, vegimet e saj duken të rëndomta dhe të jashtëzakonshme ashtu sikurse është çështja në të cilën ëndërron edhe burri për gjendjen e tij i cili duhet ta ketë në mjedisin e përbashkët.

Kjo tezë e masterit është ndërtuar në disa tërësi ku çdonjëra merret me shqyrtimin e shëmbëlltyrës së gruas dhe të burrit, si dhe funksionin e tyre në jetën shoqërore. Për këtë arsye kemi bërë përçasje në veprat e tij se

cili është roli i gruas dhe burrit në shoqërinë shqiptare të kohës. Me këtë rast veprimtaria krijuese e Nazmi Rrahmanit, në vazhdimësi duket qartë se është njëra ndër pikat referuese të këtij studimi.

## **7. Pozita dhe fati i gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit**

Domethënia e këtij shqyrtimi studimor ka për synim përimitimin letrar, qëndrimin dhe riskun e femrës në romanet e Nazmi Rrahmanit. Ndër të tjera kjo është një tematikë e larmishme e cila gjurmon një studim hulumtues të gjithanshëm në pikëpamjen letrare, artistike, të përbashkët, shpirtërore, edukative dhe të njerëzishme. Atëherë, kemi të bëjmë me vlerën e gruas në romanet e këtij autori i cili dallohet midis të tjerëve në letërsinë tonë dhe më gjerë. Andaj kemi bindjen se është një ndjenjë e posaçme kur kemi të bëjmë me mjeshhtërinë artistike dhe letrare të këtij romancierit, që manifestohet me një zakonshmëri dhe plot ngjarje të rëndomta. Sendërtimi i veprimtarisë letrare të Nazmi Rrahmanit gjithnjë e bën të posaçëm qëndrimin dhe riskun e femrës në romanet e këtij autori duke i dhënë kësaj kuptim letrar dhe estetik me një vlerë të lartë. Siç duket krijuesi ishte i nxitur prej një vargu harmonik të këtillë dhe kësisoj u jep individualiteteve hapësirën e denjë dhe të shënueshme në rrethin e shoqërisë kosovare e më gjerë, veçanërisht kur këta janë ndier të mëdyshur, të kanosur dhe të lënë në mëshirën e askujt. Këta as që e duan dhe as që janë të denjë për një realitet të këtillë të ekzistencës, mirëpo risku i ka vënë në pozicione vartëse, duke mos pasur prej ku të rreken më parë, andaj rrugëdalja e fundit është që t'u përulen risqeve të tyre që i mbart gjallimi dhe mjedisi i përbashkët. Mbase këto ishin arsytet të cilat romancierit i përshkruan tiparet dhe veçantitë kolektive të

figurave të femrave që duhet të jenë njëlloj në secilën pikëpamje me mashkullin, por edhe me femrat nafakkëputura të cilat e kapërcejnë jetën e tyre në ferr të vërtetë.

Duket se autori ka shpëtuar prej këtij merakut përmes përshkrimit interesant i cili të dridhëron shtatin. Për këtë arsye rëndësinë dhe funksionin të cilin e lozin gratë në romanet e Nazmi Rrahmanit nuk mbeten pa u paraqitur sikurse të këtilla. Krijuesi në disa nga romanet e veta konstaton sikurse gjithçka e ka domethënien e saj dhe cilado nga këta do ketë hapësirën e cila i takon rrethit të përbashkët të shoqërisë kosovare. Për këtë arsye krijuesi i dedikon një kuptim të posaçëm rëndësisë së femrës të cilën e shpalos në romanet e tij, që duhet konstatuar se paraqesin një himnizim ndaj femrave, për arsye se romancieri në tërë veprimtarinë e tij këta i përshkruan me të tëra cilësitë e larta që kanë, duke filluar prej atyre nga më të shquarat gjer tek ato ndër më të pleksurat. Romancieri i përkushton vëmendje gjithçkaje të cilën e sprovon gruaja, duke e shfaqur rëndësinë decizive që ajo ka në të tëra lëmenjtë. Nazmi Rrahmani ka prirje të veçant për të pikëzuar secilën rrethanë morale në të cilën shkon gruaja shqiptare, duke u mbështetur në emocionet e veta shpirtërore dhe të njerëzishme. Në romanet e N. Rrahmanit gratë tregohen ndonjëherë sikurse gjallesë mjaft e zemërbutë, për arsye se këta janë mbartëse të dhembshurive të thella jetike. Andaj Nazmi Rrahmani e analizon mjaft bukur figurën e femrës shqiptare duke e pikëzuar këtë mjaft mirë në krijimet e tij. Secila figurë e gruas

paraqitet njësoj sikurse është, me çështjet e ngushta, të veçorive psikike dhe morale. Një veçori thelbësore në romanet e këtij autori është figura e femrave në vështrimin e meshkujve dhe në gjithë mjedisin e përbashkët, që me vlerat e veçanta të këtyre biejnë në sy menjëherë në vështrimin tonë, e cila ndërlidhet me anë të veçorive të këtilla duhet pikasur cilin funksion lozin veprat e tij.

Ky krijues e pikëzon në aspekt të shkoqitur dhe të shumanshëm figurën e femrës shqiptare, ku secili lexues i ndërgjegjshëm dhe i vërtetë i romaneve të këtij autori është në gjendje të zbardhë tiparet e përbashkëta të saj. Shtjellimi i figurës së gruas përputhet me figurën e saj përmes hijeshisë morale dhe të botës së brendshme në të cilën ajo ka, për arsye se kjo duket si një fuqi e cila të mahnit dhe njëherit të mbanë merak. Romancieri është i mendimit se vetitë kolektive dhe cilësitë dalluese të individualiteteve kanë qenë dhe janë të nevojshme në shoqërinë shqiptare. Nazmi Rrahmani është ndër krijuesit e shquar i cili në krijimtarinë e tij në prozë i trajtoi dukuritë e rëndësishme të cilat rrjedhin nga bota jonë kombëtare që orvaten për të qenë veçanërisht të po këtij karakteri. Ky romancier si ithtar i vështrimit realist, në veprat e tij letrare e ka rimëkëmbur dramën tonë artistike duke e reflektuar këtë ndër zgjedhën e huaj, gjithashtu për të vënë në spikamë një galeri individualitetesh nëpërmjet të cilëve do ta ndërtoj figurën e heroit (heroines) të cilët luftojnë për të ekzistuar sidomos atëkohë teksa këtij i bëhet e pamundur të jetojë.



Thelbi i objektit të këtij studimi, në të cilin trajtohen dhe shtjellohen çështjet të cilat lidhen drejtpërdrejt me objektin kryesor, trajtohen në detaje, nga këndvështrime të ndryshme, siç është Hajria në romanin "Malësorja", Haziri tek "Pas vdekjes" dhe Gëzimi tek "Rruga e shtëpisë sime", të cilët përshtaten me kushtet të cilat i kishte sajuar hulumtuesi i cili nuk vërehet dhe ngjarjet tronditëse të cilat i vuri në grackë ai. Bie fjala, Hajria te vepra "Malësorja" e cila është viktimë e zakoneve reaksionare që rreh ogurin e një malësoreje të cilën e ka mëkuar me kohë pushtuesi serb të cilin nuk e rrok dot syri, sepse është i mbuluar si djalli, pothuajse nuk duket në pjesët e kësaj vepre romanore.

## P ë r m b a j t j a

Duke e sajuar atmosferën e fillimit veçanërisht para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, Nazmi Rrahmani na jep si në pëllëmbë të dorës mjedisin e njeriut tonë të Llapit dhe Gollakut (në afërsi të Prishtinës dhe Podujevës), me gjithë vranësinë e tyre tek të cilët mbizotëron patriarkalizmi dhe injoranca, varfëria ekonomike dhe zakonet primitive të gjakmarrjes, lëngimet morale të femrës e cila ka qenë plotësisht e përrulur, gjithashtu për nga formimi i gjërë arsimor e padëgjuar e cila paanësisht s'ka pasur të drejtë t'i shndërroj kushtet e veçanta që i ka kontrolluar apo mbikëqyrur qeveria antishqiptare. Këtu kosovari i sunduar dhe i shtypur realisht apo historikisht ka qenë i shtrënguar të harroj vendlindjen e tij duke mërguar për arsye të shtypjes, veçanërisht të shtrëngimit serb. Andaj në veprat në prozë të këtij autori vezullon në tërësi i ngulitur faktikisht realiteti i paanshëm i cili buron prej vërtetësisë tonë kombëtare e cila në tërësi është e përafërt në mbarë trevat tona të cilat ishin nën sundimin serbosllav. Orvatja e këtij romansieri ka qenë gjithnjë e më shumë apo më mirë duke marr lëndën prej së vërtetës së paanshme, duke u përballur me vështirësinë, vuajtjen dhe shqetësimin të cilët në të vërtetë e shprehin realitetin. Për këtë arsye në veprën "Rruga e shtëpisë sime", Nazmi Rrahmani do të shtrëngohet që të transformojë tërësinë artistike dhe veçorinë e stilit të tij prej një ndjenje të së vërtetës së përsosur në një ndjenjë realiteti të përfytyruar.

Për këtë arsye në veprën e këtillë duke e ndërtuar largësinë pothuajse të ngushtë, mund të shtrëngohet asisoj ku në shfaqjen e vet shprehet në njëjës.

Gjithashtu në po këtë vetë ky romancier është orvatur të hartojë veprën e vet të dytë "Pas vdekjes", mirëpo për arsyen e zbërthimit jo aq shumë të goditur për nga ana estetike, e lë pas dore këtë mënyrë të të shkruarit. Për këtë arsye veprat "Tymi i votrës së fikur" dhe "Toka e përgjakur" N. Rrahmani do t'i hartojë në vetën e tretë.

Vepra letrare e Nazmi Rrahmanit "Rruga e shtëpisë sime", është një shtjellim rrëfyestor që ka të bëjë me ogurin e kosovarëve të zhbërë (shkukur) me forcë prej zaptuesve serbosllav, brenda periudhës kohore të viteve tridhjeta të këtij shekulli; vendosja e këtyre dikund në Anadoll të Turqisë dhe rivendosja e kësaj popullate që kishte mbetur gjallë, veçanërisht familjet në vendlindjen e tyre nënëmadhe. Kryefamiljari i familjes së zhvendosur të Llapit, gjatë periudhës kohore 1911-12, ka marrë pjesë në luftën kundër zaptuesit osman, ndërsa tashmë, ndjehet gjunjëprerë kundrejt dhunës së egër dhe tnerruese të zaptuesit të ri, duke synuar një vend të fshehur dhe rrugëdalje tek kundërshtari i qëmotshëm. Është ky pa dyshim një përjetim i tmerrshëm i cili disa familje i vë në zgrip të shfarosjes fizike: duke u shuar një për një pothuajse tërësisht pjesëtarët e saj të cilët u arratisën në vend të huaj, për të përfytyruar ardhjen në vendin stërgjyshor, të quajtur "Përroi i Keq" (pothuajse njëlloj sikurse emërtimi i veprës, ka një pagëzim të figurshëm). Thënia

përsëritëse e mbrame, porosia e çdonjërit përballë shuarjes ka qenë: "kthehuni", testament dhe porosi kjo që e realizoi në tërësi Bajrami, djali i Rabës. Ky qysh si kalama do mbetet veqil i mënyrës barbare të shkulljes dhe zhbërjes, që ringjall imagjinatën e vendlindjes dhe shkuarjes të biri i tij që kishte lindur në Anadoll.

Një kohë, teksa mbetet krejt vetëm, veçse me djalin e tij Shpëtimin, ky arriti të vij sërish në vendlindje duke e vënë në vend amanetin e të krejtëve, gjithashtu dhe ëndërrimin e tij më të thellë. Vepra "Rruga e shtëpisë sime", për sa i përket mjeshtrisë dhe rrëfimit paraqet një shndërrim dhe sprovë të re në hullinë ngjizëse letrare të këtij autori. Mënyra e shfaqjes në këtë roman qëndron veçanërisht në ringjalljen e gjurmëve dhe mbresave. Narrativin e mbart dhe e paraprin personazhin kryesor, të cilin në pajtim me pikëpamjen e kritikut tonë letrar Sabri Hamiti, mbërrin përmasën e heroit (pra mbërrin të plotësoj vegimin e mjaft shembëlltyrave duke kapërcyer me shumë vështirësi gjatë rrugëtimit të këtyllë të rëndë, tgjyrimet të figurshme për skepticizëm dhe shkëputje tërësore kombëtare, shpesh përmes rrjedhëve tronditëse. Kryeprotagonisti shfaq çështjen e itinerarit dhe jetën në një mjedis të huaj, mëshimet e tmerrshme që vijnë njëra pas tjetrës pa ndërprerje dhe aktin e shndërrimit, i cili është pikëvrojtimi i rrëfimit. Nazmi Rrahmani e ka përzgjedhur sidomos Bajramin nga e ardhmja e tregimtarit, për arsye se i bart në vetvete dhe botën, dramën e Babait, që ka për qëllim këtë ta shoqëroj të plëngçori, pasuesi, duke mbrojtur kështu dy krahë kohorë.

Derisa tek lloji i veprës "Malësorja" romancieri tregon duke lëvizur në ecurinë e veprave të shoqërisë njerëzore, figura kryesore e cila në rrethanat e këtilla është njëkohësisht rrëfenjës i veprës "Rruga e shtëpisë sime", duke i shfaqur gjurmët e trimërive të qëmotshme. Te tipari i parë vetitë lindin dhe krijohen përgjatë rrjedhës së përmbajtjes, kurse tek karakteri i dytë këta janë të parapërgatitur, me veti të veçuara të tipareve të përbashkëta, të ndërgjegjes dhe mendimit të domosdoshëm.

Te lloji fillestar i veprave të këtij romancieri shfaqet në vetën e tretë sidomos si një bashkëbisedues modest, pothuaj në lartësi të mendimit jetësor, ndërsa te vepra "Rruga e shtëpisë sime" personazhi kryesor shfaqet në vetën e parë. Bashkëbisedimi tek vepra e këtillë duket se i përket zhanërit përkujtues (siç bie fjala, më besohet, më kujtohet, etj.) kësisoj zhvillohet biseda ndërmjet prindit, djalit dhe nipollit, pothuajse rëndom edhe përmes egos së dyfishuar të figurës kryesore, të zbatuara si kuvendim të bashkëbisedimit me vetveten. Veprat e Nazmi Rrahmanit karakterizohen me një fabul të veçantë, me rrëfim realist, përshkrues, detajist dhe me kompozicion të fortë, ku personazhi i paraprinë situatës. Atëherë, shëmbëllimi ndërmjet një lloji të veprave të N. Rrahmanit dhe llojit vijues gjendet në planin e ecurisë ngjizëse, ndërsa si dëgjuesë dhe ndjenjë e romancierit, në rëndësinë e mjeshtërisë artistike gjatë jetës.

Lidhur me veprimin e tij ndikues mbi natyrën e individit dhe pikëpamjen e të ndodhurit ose të ekzistencës, përmbajtja është formësuar duke mbetur e njëjtë gjatë tërë krijimtarinë letrare në prozë të Nazmi Rrahmanit.

"Rruga e shtëpisë sime", ndryshe prej veprave paraardhëse të këtij autori, sikurse u vu në pah, ka ravizuar një copëzim të gjuhës së shfaqur. Për këtë shkak kinse i ka paralajmëruar me kohë veçoritë thelbësore të njëfarë shfaqjeje të re të tërësisë së ngjarjes, të individualiteteve, të periudhave ose në veçanti veçoritë thelbësore të një veçorie të re të stilit në veprën e N. Rrahmanit që duhet të soditet në disa pikëpamje. Ndërmjet këtyre pikëpamjeve të mënyrës së të rrëfyerit në vargje, gjithqysh është mbrojtja dhe ruajtja e kuvendimit përmbajtësor apo i një karakteri dhe lloji modern të bashkëbisedimit të individualiteteve mbi të cilët mund të flasim.

Në veprën e këtillë, megjithëse aty-këtu me njëfarë gjallërie dhe kumtimi arrijmë tek shfaqja e llojit të ri të bashkëbisedimit midis tregimtarit dhe heroit kryesor që janë zbuluar pohuese me njohuri të gjera e të thella. Në kuadër të krijimit të këtillë që është mjaft i ngjeshur që rrëfimin e pasqyron nëpërmjet kuvendimit përmbajtësor përmes ndeshjes të krijuesit dhe personazheve të kësaj vepre, të cilët njëkohësisht s'ndodhen veçse si tipare që i përkasin karakterit tipik, mirëpo jo vetëm fjalë ose shprehje apo ndërtime që kanë kuptim të njëjtë ose shenja përfytyrimi të krijuesit (tjetërsoj prej tërësisë së emërtimeve

të ndryshme dhe të zakonshme, të vërteta, të veprave paraardhëse, sipas një tipi të caktuar që është tërësi emrash dhe vendesh të figurshme siç është Përroi i keq, tjetërsoj prej emërimit të vërtetë të figurave kryesore shërbehet me emërtime ose figura të tepërta siç është - çlirimi jonë, qejfi jonë).

Përmes rrëfimit të kësaj vuajtje të theksuar të procesit psikik shpirtëror, për këtë arsye veçanërisht bashkëbisedimeve të vogla të çastit duke i sqaruar individët, duke u çliruar prej mërzitshmërisë dhe shfaqjes, kjo vepër përjeton arritje të mbara dhe të madhërishme tamam me ngjeshjen e karakterit a llojit të përtërirë të ligjërit gojor tipësor, ngaqë ndërlidhet me kuvendimin shpirtëror të rrëfimitarit, nga të shprehurit në vetën e parë, duke iu bindur ecurive të botës së brendshme të shkrimtarit, të tërësisë së çështjes dhe thelbit që lidhet me anën e tërësisë së pikëpamjeve të realitetit logjik të fjalës.

Përmes bashkëbisedimit përkujtues në bazë të së cilës është hartuar vepra "Rruga e shtëpisë sime", nuk duket veprimi ose efektimi aktiv. Për këtë arsye aq fort lë vragë pikëpamja, veçanërisht tempa i artit të fjalës që është i mangët, ndërsa fuqia e brendisë së saj për këtë arsye e plotëson me fuqinë e rrëfimit të individit përballë grupit të njerëzve. Individu përshkruhet në situatën e vet vepruese, sidomos me ethet e përfytyrimit apo të ankthit, të dhembjes duke e evokuar të shkuarën përmes kësaj veprë i shfaqet babai të birit, babagjyshi nipit, ashtu sikurse në kuvendimin me vetën e dialogëzuar, egoja e dytë kur i flet egos

fillestare, këta bëhen gjithherë e më të ndërgjegjshëm ndaj të sotmes së tye, duke ruajtur në kujtesë veçanërisht përndjekjet fizike e sidomos botën e brendshme, të së shkuarës që janë bërë të jashtëzakonshme, të mësuara dhe të gjalla. Qysh në djep, në foshnjërinë e vet, vogëlushi kupton sesa të pavlera kanë qenë lojërat me nuska, pallatet prej kumi ose anijet prej letre, kësaj vërtetësie aty për aty ia mbulon të mirëfilltën, individi i ardhshëm (në veprën e tillë veta e dytë e rrëfimitarit) domethënë qysh në fëmijërinë e vet, në ambientin ose në çastin të cilin e qarkon, do ta marr vesh realitetin e ashpër, jo veçse të njëmendëtën e ashpër.

Dialogu evokues, sikurse u përmend paraprakisht, gjithashtu derisa rafinon njëfarë mbijetoje të ëmbël dhe njëfarë kënaqësie të botës së brendshme, e cila ka larmi shpirtërore emocionale, veçanërisht pors ligjërim i "gjallë" i të shfaqurit me anë të cilit pasqyrohet fuqia e individit nga mbijetoja e rrëfyesit, figurë e cila e rrëfen veçorinë e saj në këtë vepër. Duke e ndjerë pasojën e disfatës dhe duke mos patur arritje të mbara, fillimisht teksa e detyrojnë të "çrënjaset" prej vendit të vet, veçanërisht herën e dytë meqë është i detyruar të ngulitet në një mjedis të huaj të cilin ai pothuajse as që e ka dashur.

Dialogu rrëfyes i veprës "Rruga e shtëpisë sime" të Nazmi Rrahmanit shprehet pors ndërgjegje historike apo si ndërgjegje e rryer shqiptare, që është regjur ndër vrullet e së kaluarës. Evokimi duket sikur një emocion i dëlirë i individit i cili as që lëngon prej shfaqjes së zjarrtë,



ndërsa evokimi porsì sentiment është një përmasë ndjeshmërie e cila e bën gjuhën më elastike, ndërsa personin të cilin e përmend e bën më të tërësishëm apo më të plotë në pikësynimin përfundimtar të tij. Shfaqja rrëfimore në fakt duket një shtjellim i thellë i tregimtarit përballë grupit të njerëzve për qëllime të përbashkëta, andaj paraqet një lloj ndërgjegjësimi të secilit personaliteti nga shëmbëlltyrat dhe gjer tek lëçitësi dhe mënyra nëpërmjet të cilës investohen parime apo përgjithësime që rrëfyeni i ka mbikëqyrur për të cilat është i bindur me saktësinë e vet. Për këtë arsye në veprën "Rruga e shtëpisë sime", babagjyshi, i ati po ashtu i biri, e rishfaqin një tipar të njëjtë, një individualitet dhe një pikëpamje të ngjashme përballë së vërtetës, ndërsa fryti i shpërputhjes së tillë është shfaqja evokuese.

Tek kjo vepër gati-gati asnjëherë as që vihen përballë individualitetet e dialogëzuara, domethënë as që bëhet copëzimi i pikëpamjeve që janë në kontradiktë gjë që është njëra prej mangësive të kësaj vepre. Për arsye se sa më shumë që e fuqizon një gjuhë të këtillë të shfaqjes, aq më lehtë Nazmi Rrahmani ua hap dyert nuancave të artit të poezisë gjithashtu joreale të thirrjes dhe jehonës me të cilin individualitetet rishfaqen ndërmjet tyre. Romani "Rruga e shtëpisë sime" meqenëse është vepër e vetme e cila jep thjesht një lloj të kumtimit me lëçitësin, duke e konceptuar shfaqjen evokuese si një mënyrë e pasqyrimit të botës së brendshme të shëmbëlltyrave tek të cilët vërejmë acarime ose vlerësime të shumëllojshme.

Në veprën romanore të Nazmi Rrahmanit, shtjellohet shembëlltyra e gruas ku gjithashtu çështje kryesore ka qenë rëndësia e saj si femër në romanet e këtilla të krijuesit. Ndaj i kuptojmë me një ëndje të posaçme romanet e autorit. Përqëndrimin tonë e josh në aspekt të posaçëm femra kosovare e cila duket goxha e theksuar në veprat e këtij romancieri. Krijuesi për ta pikëzuar shëmbëlltyrën e femrës, kësaj i përkushton hapësirën e denjë në mjedisin e jetës shoqërore kosovare. Një gjë e tillë do të thotë mirëfilli se Nazmi Rrahmani e zotëron bukur mirë përfytyrimin e periudhës së kaluar, prandaj e pikëzon mjaft mirë personalitetin e femrës, që në disa çaste na diket sikurse jemi të pranishëm këtu pranë duke e vështruar ndodhinë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Krijuesi s'le mënjanë që të pikëzoj paraqitjen e gruas për të pikasur një mori fjalësh përcaktuese të përkryera të llojit të vet.

Përmes pikëzimeve të cilat i krijon, shumë kollajshëm e vërejme rëndësinë të cilin e loz femra në këtë vepër, që e veçantojmë atë prej shoqja-shoqes, meqenëse shkrimtari e cilëson shëmbëlltyrën e femrës goxha shumë, duke e shpalosur gruan porsì një botë shpirtërore të hijshme, siç ishte baresha Hajria e cila rritet duke u zbukuruar. Hajrija e cila kishte përballuar duke qenë gojëmyllur brenda gjithë jetesës duke treguar vendin e femrës nga ky ambient, teksa përballlet me të vërtetën e këtillë tronditëse, futet, e rrit intonacionin duke arritur të ia mbush

mendjen birit të dytë për të hequr dorë prej qëndrimit të prerë lidhur me vrasjen e vëllait, i cili ka qenë së fundmi ngadhënjimi shpirtëror i Hajrijes.

Gruaja shfaqet si e paprekshme, sidomos në disa prej veprave letrare të N. Rrahmanit, kjo është e përvulur brenda gjirit shtëpiak, veçanërisht në mjedisin ku jeton, për arsye se nuk kishte asnjëfarë autoriteti, apo dinjiteti ose është shumë e përçmuar. Nga gjithë kjo, veprat letrare të Nazmi Rrahmanit paraqiten me shumë copëza të gjallimit të cilat duken të njëmendëta. Ekzistenca e grave duket goxha magjepsë. Çdonjëra nga ata e ngërthen individualitetin e vet, është njëkohësisht grua rrebemadhe gjithashtu e mëvetësishme e cila e bën veprën mjaft joshëse ndaj lëçitësit. Gratë e këtilla duken të posaçme duke ndryshuar shumë përsa u takon tipareve. Me një fjalë, çdonjëra nga ata shfaq një botë të veçant. Nazmi Rrahmani e pikëzon bukurinë femërore duke u zbukuruar me vetitë dalluese, veçanërisht me cilësitë morale të saj. Gjithashtu bukurinë e gruas e shpreh thjesht në një vijëzim, në të cilin është tipari ai i cili e bën këtë grua të jetë e përsosur në vetvete.

Një gjë të tillë autori e bën me një kuptim të shkëlqyer, duke u përpjekur me anë të shembëlltyrës së tillë, t'i shpreh në veçanti pikëpamjet e tij lidhur me jetën e qenies së gjallë. Për këtë shkak, femra në veprat romanore të këtij krijuesi shfaqet në rolin e edukatores e cila është në situatë të trajtësojë shqetësimet e saj duke luftuar mbi këta.

Mjaft figura grashë të cilat i ndeshim në romanet e këtij krijuesi, vihen përballë vërtetësisë me ekzistencën të cilën e krijojnë. Me anë të shembëlltyrës femërore, autori në romanet e veta e vijon luftën shpirtërore të gruas dhe çlirimin nga vartësia, duke flakur tej paragjykimet. Gruaja është e mbërthyer në mënyrë të afërt me mjedisin apo periudhën në të cilën rron. Ky krijues e detyron shembëlltyrën e gruas të shprehet me forcën e saj e cila është në situatë t'i kundërvihet të shëmtuarës. Në disa vepra krijuesi dëshmon për vëmendjen e thellë të cilën ai e ka përballur rolin e femrës ndaj jetës.

Duke e lartësuar gruan në një nivel mirësie dhe bukurie, shkrimtari orvatet t'i shmanget së keqes që e rrethon. Shembëlltyra e femrës në bazë të këtij krijuesi gjëllon në pjesën anësore të saj. Oguri i cili e ndjek femrën gati sa s'është e kushtëzuar prej pjesës përbërëse të shtresave, meqë tmerrin e gjëllimit e nuhat njësoj si gruaja skamnore gjithashtu edhe ajo e kamura. Gruaja shpalolet me ëndërra të pazbatueshme, e cila e koncepton jetesën sikur të ishte një dështim. Në krijimet letrare të këtij krijuesi ka pjesë të posaçme gjithashtu dashuria e gruas, të cilën e zotëron porsin një konceptim të pavdekshmërisë. Një dukuri e tillë duket si një forcë e cila dërrmon gjithçka përballë saj duke qenë gruaja vetmitare e cila do i bëjë ballë kësaj force.

Jetesa e saj, madje është një koncept mendimtar ose i vërtetë. Për shkrimtarin ka kuptim vetëm nëse në të bën pjesë femra si simbol i dashurisë dhe bukurisë. Njëpërmjet brendisë së krijimeve letrare të N.

Rahmanit, vihen në pah të gjitha të metat e shoqërisë shqiptare. Femra në veprat letrare të tij duket se i është përrulur natyrës së saj të mëvetësishme. Sipas kësaj sillet rreth e rrotull gjithashtu mjedisi e veçanërisht farefisi. Gruaja është e tjetërsuar e përbuzur dhe herë-herë vihet në shërbim të së keqës nga e cila së pari e pëson vetë. Nazmi Rahmani çështjet e këtilla i ka vënë në pah në romanet e tij me synimin, që prej tyre njeriu ynë të ndeshet me shtrembëritë të cilat i janë bërë femrës, duke besuar se brenda ditës do kenë rastin të ndjejnë ngadhënjimin e fitores. Figurës së gruas ky romancier i kushton një rol shumë të rëndësishëm. Femra është një tipar i veçant dhe i gjithmbarshëm i lëngimeve shpirtdhembshura. Në ca publikime ajo del në një rrethanë që nuk mund ta jetojë as rininë e saj. Kësisoj femra ka për qëllim të demaskojë mendimin prapanik viktimë e të cilit është vetë ajo. Dhembjen e këtyre femrave nuk e vëren asnjëri, ngaqë secili orvatet t'i lë mënjanë ato një ditë e më parë. Ngaqë gratë do u kthenin atyre përsëri në jetë, dallim ky të cilin këta as që ia dëshirojnë vetes së tyre. Sikurse krejt gratë tjera gjithashtu edhe këta e duan jetën, për këtë arsye durimi i tyre ka qenë i thellë, ashtu sikurse dashuria e cila ka ndaj jetës. Gruaja i bën ballë çfardo çështjeje duke e duruar mëtej barrën e cila rëndon përmbi shpatullat e saj, veçse për të pasur jetë të shtruar duke pikasur fatmirësinë. Gratë e këtilla shijojnë një vetëqenie hijerëndë meqenëse vërsulen në llërët e atyre të cilët nuk janë të denjë për të pasur kujdes e vëmendje.

Duke u dhuruar shpirtin të tillëve, ato qëndrojnë të heshtura përballë një dhembjeje të madhe. Ata shpesh qeshin dhe shfaqen të lumtura, ndërkohë që shpirti u qan.

Figura e Femrës është paraqitur me të gjitha virtytet e gruas së zakonshme. Gruaja di t'i shfaq tiparet besnike të saj, për arsye se është një botë objektive, e brishtë, emocionale po ashtu me shumë imagjinata që janë të lidhura me ekzistencën, andaj është një trimëreshë zemërbutësie.

Romani "Malësorja" është rrëfenjë e rrëfatur ndaj jetesës së figurës qendrore, Hairijes, mirëpo edhe shfaqje ndaj një morie mbartësish të ndryshëm të ndodhive të cilat bashkarisht krijojnë pamjen reale dhe realiste të një mjedisi kosovar mes dy luftërave botërore. Kryepersonazhi, Hajrija, në këtë vepër nuk është e karakterit të formuar, të gatshëm, por formohet gjatë shfaqjes, e cila zhvillohet në bazë të mjeshtërisë kronologjike, të ndërprerë dhe të ndërpleksur herë-herë. Formimi i Hajrijes ndiqet sipas linjës së brendshme të shpalimit, nga motivet, pretendimet, vizioni i saj i brendshëm, kryesisht i ndrydhur, i heshtur, dhe jo nga veprimet e saj. Nga përjetimi i një drame në tjetrën, ajo gradualisht vetëdijësohet për pozitën e saj të nënshtruar, për mundësitë e veta të kufizuara, por tërë atë ngarkesë e bart në heshtje dhe dhimbje të plotë. Autori nganjëherë e bën të zëshëm vajin e saj të brendshëm vetëm përmes monologjeve të saj, dhe më rrallë përmes ndonjë dialogu, ndërhyrjeje apo sqarimi të çastit. Pikërisht përmes kësaj

pjese të përmbajtjes narrative, autori arrin të shpalosë botën e brendshme të Hajrijes nëpërmjet rrëfimit psikologjik.

Ngjarja në këtë roman rrëfhet në vetën e tretë dhe nga pozicioni i narratorit të gjithëditur, që nënkupton distancën e autorit, përkatësisht mundësinë e pozicionimit objektiv rrëfyes. E gjithë bota e rrëfyer shikohet me sytë e Hajrijes: nga ky kënd sajohen mekanizmat. Anësimi në favor të kryepersonazhit, bëhet i dukshëm sidomos në momente kur narratori nuk përmbahet dot nga ndërhyrjet e motive të llojit: "e mjera (Hajrija), e ngrata, ..." etj. Vizionin e vet për vlerat jetësore, Hajrija arrin të shpalosë botërisht pothuajse në mbyllje të rrugës së saj jetësore. Kur e ndien se fundi i saj do jetë shumëfish më e tmerrshme nga ç'ka qenë Golgota e përjetuar, ajo vendos të veprojë dhe të kishte rezultat. Ngadhnjimi i saj moral, në të njëjtën kohë është dhe paralajmërim për një cilësi të re jete, sidomos në rrafshin e pozitës së femrës, por dhe një mënyrë e gjakmarrjes kanunore. Këmbëngulja e saj vjen dhe si një sprovë, si një sfidë që i bëhet qëndrueshmërisë së kësaj plage. Dhe vetëm pas disa dekadave nga data e botimit të veprës (1965), në fillimin e viteve nëntëdhjeta, në mbarë Kosovën do shtrihet dora e pajtimit.

Vetëdija se gjakmarrja mes shqiptarëve është pasojë e jetës në robëri, u formua pikërisht në valën e dhunës së egër serbosllave mbi shqiptarët e Kosovës. Mund të konstatojmë se vepra mbi fatin e Hajrijes, degëzohet në një mori rrjedhash jetësore që derdhen të gjitha drejt rritjes

së personalitetit të vet dhe drejt qëndrimit të guximshëm ndaj konvencioneve zakonore me pasoja tragjike.

Tregimi magjepës për bareshën Hajrijen të palumtur dhe jetëshkurtër, e cila lidh martesë dy herë dhe kurrë me vullnetin e vet, që, prapëseprapë, gjatë rrojtjes së vet të raskapitur, tek ajo ndeshim tipare dalluese të qejfeve, të gjallërimit të cilat i japin fuqi për të jetuar ose mbetur në gjallërimin e këtillë. Hajrija e cila ka njëkohësisht tipare të veçanta ndaj dashurisë së dëlirë dhe zemërbutë e cila në vazhdimësi ka lindur te kjo duke u transformuar në një dashuri të mirëfilltë dhe besnike, kundrejt dy burrave të cilët as që i ka përzgjedhur personalisht. Pra, kësaj dashurie jetësore që është flijimi i vetes, veçanërisht kundrejt burrit, nënës dhe babait të fëmijëve të saj dhe njëherit nga prijësit e vatrës që s'është shfaqur në mënyrë banale, të pazakonta, ose me zënka tradicionale dhe përzgjidhje shabllonesh, ashtu siç rastis ka herë në veprat letrare a botimet periodike me brendi të këtilla të përafërta.

Autori duke qenë në moshë të re është përqëndruar atëherë më shumë në thelbin e lidhjeve të përbashkëta apo humanitare në vatrën e prapambetur kosovare e cila përmes riskut të Hajrijes është shfaqur një mendësi, apo një etikë e cila ishte mbrujtur radhazi ndër qindvjeçarë e cila është kultivuar deri në ditët tona në një trajtë të ndryshme. Në riskun e Hajrijes dhe vështrimin fillestar, dallojmë një lloj besimi të verbër tek fati. Këtë e shoqëron një taksirati nga i cili prej këtij çasti të papritur teksa i humbin dhentë në pyll.



Hajrija duke i kërkuar ndër male deri në mënesë në mbrëmje, bie pre e dy karaktereve të degjeneruar të cilët orvaten ta çnderojnë, kurse mbas këtij bëhet "çikë me dangë", deri tek jeta bashkëshortore e panatyrshme me Halilin e moshuar e topall dhe shuarja e jetës së tij pikërisht në çastin teksa Hajrija e gJORë ka filluar të parandiej njëfarëlloj dashurie shpirtdhembshur ose nderimi kundrejt këtij në funksionin e burrit apo individit që është moralisht i pastër dhe bujar. Gjithashtu më vonë e keqja e shoqëron Hajrijen fatmjerë. Këtë, tashti, si grua e re që mbeti e ve, lidhi martesë me Nezirin goxha më plak, i cili në lidhjen e parë bashkëshortore të tij s'ka pasur fëmijë.

Neziri bie pre e hakmarrjes mu në çastin teksa në kullën e këtij Hajrija lind djalin e mirëpritur për një kohë të gjatë. Në këtë ngjarje të rëndë dhe tronditëse ndaj një femre shqiptare, ndeshim elemente që janë njëfarë hepiendi në fund të romanit, ndërsa Hajrija ia krij trurin të birit që mos të ia marrë jetën byrazerit të vet, vrastar i babait, ashtu siç mund të kishte një tingëllimë të shkoqur ndërtimi, veçanërisht artificialiteti në kacafytjet dhe shkoqitjet e ngjarjes gjithashtu aksionit që zhvillohet në roman. Në këtë mënyrë duket me një mori ndodhishë ose veprimesh risku i fatit të Hajrijes, sidomos një varg ndodhishë që ndërliidhen veçanërisht me familjen e saj, që janë dhënë në një kompleks logjik, me njohuri të ambientit, atmosferës dhe fshatit në veçanti, elemente të cilat e bëjnë veprën e këtillë pothuajse mjaft mbresëlënëse, njëherazi të zakonshme dhe origjinale. Rrëfenjëzën e saj në çastet e këtilla

romansieri e ka karakterizuar me shtjellime mjaft të bukura, ka herë fare lirike, të cilat e fisnikërojnë veprën e N.Rahmanit duke e bërë mjaft të ngrohtë, të drejtpërdrejtë dhe të përafërt.

Për këtë arsye ndeshim njëkohësisht veçori thelbësore, të cilat nuk i duron romani bashkëkohës, mirëpo në esencë ngjarja rrjedh në mënyrë të natyrshme po ashtu mjaft interesante, me ekspozicion, konflikte e shkoqitje të logjikshme që të lënë mbresa bindëse dhe impulsive.

Në këtë vepër vërehen shumë figura magjepse të shprehura gjithashtu në një aspekt mjaft të gjallë nga një mjedis që është jo aq i dëgjuar në artin e pasur letrar shqiptar. Ideja është ajo që na josh më shumë dhe me vlerë është ideja e shtjelluar me mjaft arritje të mbara në triumfin e jetës, në rrethanat e mundimeve më të rënda trupore, morale dhe njerëzore. Ideja e fitores së plotë të forcës së njerëzishme apo jetës që është e mishëruar në shembëlltyrën e një malësoreje të zakonshme kosovare, në një ambient e cila akoma mundohet nga barra e neveritshme e zëmit dhe jetës së prapambetur. Të gjitha mundimet dhe vështirësitë e jetës në rrugëtimin e vet neveritës janë çdonjëra veçori në vetvete porsia një dukuri që e ka vëzhguar jetesën në fshatin shqiptar, përmes të cilave gjindja ishte ndeshur duke triumfuar apo duke mos patur ndërmend të tëra. Njëherazi fuqia e përputhjes apo mposhtjes përballë ogurit të riskut, nuk është shfaqur në këtë mes sikur të ishte sundim dritëshuar kundrejt riskut kur ndërpriten krejt rrugëdaljet, sikur të ishin fenomene, apo dukuri që kishin ndodhur të pamënjanueshme në

një kohë shumë të shkurtër të ekzistencës mjaft të zbehtë apo të pllakosur në caqet e prapambetura.

Andaj krijuesi ka hartuar një shumicë pamjesh të veçanta të gjallërimit të mjedisit, nga i cili formohen ose përsosen personazhet e romanit. Vepra e tij dëshmon shkallën më madhe të ndjeshmërisë së tij prej shkrimtari ndaj gjuhës shqipe në përgjithësi dhe gjuhës së popullit në veçanti, por në mënyrë të spikatur, gjithnjë në përputhje me nevojat artistike të veprës, përdoren edhe dialektalizmat. Kështu, gjuha në romanet e tij, përveçse gjuhë krahinore, është dhe gjuhë kombëtare.

## P ë r f u n d i m i

Dhunëtia e rrëfimit bindës, në stil që u rri afër kronikave artistike për bëmat dhe aventurat nomade, e bën atë që të rrumbullakojë bukur botën e romaneve të tij, në pikëpamje të ideve, të personazheve të kompozicionit e të stilit. Në krijimtarinë letrare në prozë i ka trajtuar dhe rrahur dukuritë të cilat rrjedhin prej botës sonë kombëtare të cilat orvaten të jenë ekskluzivisht të kësaj natyre. Duke hedhur në dritë një galeri individualitetesh me anë të cilëve do ta bëjë përshkrimin e figurës së heroit (heroinës) i cili lufton duke ekzistuar edhe atëherë kur atij i bëhet e pamundur që të gjëllijë. Vepra "Malësorja", ndërthur në thelb një varg harmonik shumë interesant që buron prej gjallimit të kohës së katundit kosovar. N.Rrahmani e përshkruan në një kuptim goxha të zakonshëm mirëpo të drejtpërdrejtë fshatarët e lokalitetit të tyre, duke qenë të përmendur me ndjenjën e kënaqësisë, brengosjet, veçoritë, virtytet, hidhërimet dhe mangësitë, në atë mënyrë sikurse i kanë dëgjuar në moshën fëmijërore dhe atë të rinisë, në kuptim të drejtpërdrejt nga burimi i gjallimit në fshat. Hajria fatligë te Vepra "Malësorja", është viktimë e zakoneve reaksionare të cilat i mëkon nënshtruesi serbosllav i cili në realitet duket i papashëm në faqet e romanit. Haziri te ("Pas vdekjes"),Gëzimi te ("Rruga e shtëpisë sime"), ballafaqohen me kushtet të cilat i ka shpikur pushtuesi i papashëm apo "dramat" të cilat i kishte nxitur ai. Sikurse është Hajria te vepra "Malësorja" e cila bie viktimë e

zakoneve reaksionare të cilat i gjëllin pushtuesi serbosllav i cili në të vërtetë duket i papashëm në pjesët e veprës letrare.

Stili i rrëfimit të tij mbetet i njëjtë që nga vepra e tij i parë "Malësorja" (1965), e cila është midis veprave me peshë të veçantë, në të cilën reflektohet në mënyrë të vërtetë artistike risku i gruas kosovare. Në brendinë e kësaj vepre shpërfaqet veprimi i ashpër i burrit kundrejt gruas. Figura boshte e këtij romani është Hajrija. Një grua të këtillë malacake e nëpërkëmbin prej të gjitha anëve stuhitë e jetës që nga orët e hershme të fëmijërisë e gjer në moshën e thyer.

Kemi bindjen se vepra ka të bëjë kryesisht me ogurin e Hajrijes, që rrëfatet brenda një shumice ecurishë me pasoja të rënda jetike të cilat flaken të tëra kundër ngritjes së figurës së Hajries dhe në drejtim të qëndrimit të guximshëm kundrejt traditave dhe zakoneve të trashëguara nga e kaluara që janë me përfundime tronditëse. Rrugëtimi i domosdoshëm i Hajrisë na lë të konceptojmë sa i pakuptueshëm kishte qenë (e në disa mjedise edhe në kohën tonë) pikëpamja e burrit kundrejt gruas shqiptare (Zajmi Abdulla, Vuajtjet shpirtërore të Hajrisë, Përmendorja e fjalës, 1979, f.176-177).

Autori duke u bartur me të njëjtin kujdes të romanet tjera, siç janë: "Pas vdekjes", "Tymi i votrës së fikur", "Toka e përgjakur", "Rruga e shtëpisë sime". Ndër të tjera vërejmë se ndryshojnë apo variojnë vetëm temat. Të shtrira nëpër hapësira lokale të caktuara, ngjarjet e romaneve të tij krijojnë ndjenjën e vërtetësisë edhe përmes një

iluzioni dokumentar, sapo që imagjinaria është ajo që rrumbullakon temat si letërsi. Temat që ndonjëherë janë individuale, si te "Malësorja" e "Pas vdekjes" dhe ndonjëherë me karakter të problemeve që lidhen me një bashkësi të gjerë, si te "Rruga e shtëpisë sime" e "Toka e përgjakur". Vepra "Toka e përgjakur" si një roman rrëfyës, nga i cili pikëzohen çështje të ngatërruara të jetesës me një masë të theksuar dukurish të cilat shfaqen në rrjedhë e sipër. Në roman janë të pranishëm një mori figurash, risqet dhe synimet e të cilëve në këtë roman trajtohen hollësisht dhe me të tëra kontradiktat. Pra, proza e Nazmi Rrahmanit, sa është prozë e karakterit dhe sa e fatlumit të bashkësisë, nga fati i individit te Hajrija, kalohet te fati i keq i një bashkësie të tërë, i shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi nga presioni serb, siç e shohim te "Rruga e shtëpisë sime". Jeta njerëzore në këtë prozë frymon brenda kërkesës për ruajtjen e qenies fizike sa dhe identitetit kombëtar, gjithnjë duke ruajtur vatrën dhe tokën. Brenda këtij konteksti dalin edhe paradigma të veçanta që tregojnë lidhjet e personazheve me traditën shqiptare. Dimensioni shpirtëror i personazheve duket shumë i ngjeshur nga anë të jashtme che të brendshme, prandaj edhe rrëfimi vlon nga dramatika e personazheve që rrjedh sa brenda, aq edhe jashtë, në veprimet e tyre.

Rrëfimi realist në romanet e Nazmi Rrahmanit, mbështetet mbi parametra të iluzionit dokumentar, madje edhe duke krijuar iluzione mjaft të sakta të kohës dhe hapësirës, në kuptimin historik.

Por sipas rrëfimit realist, hyrja bëhet pas dhënies së një uverture në të cilën duket ambienti che personazhet në të, duket jeta dhe mënyra e jetesës, duket bota e atyre njerëzve me gjithë telashet dhe bukuritë e pakta të vetat. Teknikat e rrëfimit, të "Rruga e shtëpisë sime", zhvillohen edhe përmes formave të evokimit, retrospektivës dhe të kombinimit me forma të tjera, duke krijuar një tension që zgjon interes dhe efekte të një procedimi të veçantë letrar.

Vepra "Malësorja", paraqet një gjallërim mjaft të rëndë të një fshatareje kosovare, lidhur me arsyet e pikëpamjeve të shtrembëra të njerëzve tanë dikur ndaj botës femërore, e cila gati-gati, nuk kishte klurfarë të drejtash njerëzore. Në këtë vepër prozaike qysh në fillim konstatojmë që subjekt i rëndësishëm është gruaja, domethënë, femra arbërore, një femër malësore, përmes së cilës janë dhënë dy botëra, të cilat luftojnë herë njëra herë tjetra me ashpërsi. Atëherë, bota patriarkale dhe ajo progresive, që ka filluar të depërtojë, duke e ngrisë zërin ndaj shtrembërimeve dhe ngulfatjeve shoqërore kundër femrës tonë.

Femra ka mjaft funksione gjatë tërë ekzistencës, së pari porsin një gocë e vogël, e përfshirë në çështjet e kullës, mandej që në vitet e njoma të brezit të ri është e shtrënguar të lidhë martesë dhe të ndryshojë gjendjen me ose përveç vullnetit të vet, të emërohet fisnike, më vonë bëhet nënë, një nënë tejet e devotshme ndaj fëmijës.

Devotshmëria e vet përballë fëmijës shkon aq larg sa që ajo më jetën e saj nuk mund t'a përfytyrojmë të ndarë nga i biri dhe e bija, që nga ai çast nëna jeton vetëm ndaj foshnjës së vet duke e mbrojtur fëmijën me të gjitha mënyrat e mundshme.

Pra, vërehet mirëfilli se N.Rrahmani e ka përshkruar gruan dhe gjendjen e saj mjaft të rëndë, sepse femra është vështruar para së gjithash rëndomë si një trup i vdekur ndaj së cilës vendimet i marrin të tjerët! Thjesht, femra gjatë gjëllimit të vet nuk ka në dorë asgjë! Mbi vetveten ose thënë ndryshe mbi fatin e vet gjatë gjithë jetës e përcaktojnë në fillim kur është një gocë babai, mandej kur martohet vajza detyrimi i mbetet burrit të saj, por sikur bashkëshortit t'i rastiste ndonjë gjë e papritur ose ndonjë fatkeqësie, atëherë çështjen e përcaktojnë prerazi të dy palët e familjeve të tyre se çfarë do ndodhë me gruan që bie pre e këtij kurthi.

Gruaja atëbotë konsiderohej veçse si një e keqe dhe e zeza e familjes, femra duhej të bëjë mjaft kujdes duke mos bërë gabim që do ia nxinte fytyrën familjes. “Gruaja nuk ban me hi te burrat. Nuk ban me e dit' edhe ajo rreth kësaj meseleje. Burra janë dhe ata duhet me i ndreq këto. Ata bajnë çka duen, ndërsa grueja nuk guxon me u përzie në punë të tyre. Kështu kanë ba gjithmonë e kështu bajnë edhe sot ..”. Femrat s' kishin aq fuqi për të kundërshtuar fatin e tyre të mjerë. “Unë me e marrë



Zekën?.. Ai burri im? Ai?.. Po unë ate e kam rritë e mbajtë ma shumë se nana e vet. Jo ishalla! Kurrë !..” (Rrahmani N., 1978:64)

Një fat i tmerrshëm të cilat e kishin pothuajse shumica e grave ishte edhe kjo, që pas vdekjes së të shoqit atë ta kthenin për ndonjë mashkull tjetër të familjes! Në të shumtën e rasteve gruan e kthenin për vëllain e të ndjerit ose për djalin e vëllait që shpeshherë ndodhte të ishte i vogël në moshë për të mos thënë fëmijë. Kjo ishte një pozitë tepër e vështirë në të cilën ndodhej gruaja, asaj nuk i lenin asnjë rrugëdalje tjetër dhe as që kishte të drejtë të veprojë me jetën e saj si të dëshirojë, pra në çdo vendim që merrnin të tjerët asaj i mbetej vetëm të veproj në atë mënyrë e assesi ndryshe .

Gruaja detyrohet të martohet sërish pas vdekjes së burrit të parë, e përsëri pa pëlqimin dhe dëshirën e saj, detyrohet poashtu të ndahet nga foshnja, gjë që është shumë gjendje e rëndë për një nënë e cila ndahet dhe e lë dikund tjetër shpirtin e saj. Pas këtij momenti ajo jeton vetëm me kujtimet e saja që kishte në kokë, nuk kishte shumë rëndësi më se çka do të ndodhte pas asaj ndarjeje aq mallëngjyese që ka e ëma me foshnjen që ende pi qumësht në gjirin e saj, andaj dihej që edhe vendimet e mëtutjeshme do merreshin nga familjarët e afërm. “A thue me i thanë tash a nuk mund të çohet a? Për djalë do të çohet sepse e ka dëshirue shumë!..” (Shita, V., 1980: 200).

Shfaqet edhe një karakteristikë tjetër tejet e veçantë që kishin njerëzit apo thënë më saktë shqiptarët për gjininë femërore, femra nuk

luante aspak rol në vazhdimësinë e fisit apo familjes, nuk e merrnin parasysh si trashëgimtare, por ishte djali ai i cili ia hapte dyert shtëpisë, oxhakut dhe kjo shtëpi nuk mbetej shkretë nëse kishte për trashëgimtar një mashkull.

Një çështje e këtillë ishte bërë edhe si zakon që patjetër në çdo konak sa më shumë meshkuj që kishte aq më shtëpi e madhe quhej! Në rast të mungesës së fëmiut me gjini mashkullore, akuzohej gruaja, thua se ajo vendoste se çfarë gjinie do t'a lindte foshnjen!

Një grua që lindte vetëm meshkuj duhej dhe ishte më e respektuar nga të gjithë, veçanërisht nga i shoqi, gjë që ishte një padrejtësi e madhe ndaj grave të tjera që e ndjenin veten gjithmonë të mallkuara nga perëndia sepse ato nuk mund të lindnin djal?!..“.. mos po më detyrojnë prap të ndahem, sikur prej Alisë ? ” (Shita, V., 1980: 205).

Thua se fati dhe jeta e vështirë e ndiqte gjithmonë si hije pas gruan e cila nuk dëshiron gjë tjetër pos të krijojë një familje të lumtur me fëmijët e saj, me të shoqin për të cilin mezi kishte arritur të ndjejë diçka pasi e kishin martuar pa dëshirë familjarët siç bënin në raste të shumta ...Pasi të lindte dhe të bëhej nënë gjithçka merrte fund dhe asnjë gruaje nuk i bie ndërmend e as që e mendon të ndahet nga engjulli i saj, që nga ai çast kur një grua bëhet nënë jetën e vet ia kushton tërësisht atij, thjesht ajo jeton më vetëm për atë dhe asgjë tjetër. “Dy gratë e Nezirit, Hajria dhe Raba, qajtën tërë ditën nga i njëjti shkak, për të njëjtin njeri. Secila

në vete dhe në mënyra të ndryshme e ndjente dhembjen dhe pikëllimin për burrin e vet – për Nezirin” (Hamiti, S., 1982: 206).

Ajo që ndodhte shpesh nëpër familje ku gruaja fyhet e nënçmohet shumë rëndë është edhe ky fakt ku burri siç thamë e fajëson të shoqen për mos lindjen e një djali, e quan atë si të paaftë, të dobët fizikisht e jo të denjë . Për këtë arsye ai e sheh të patjetërsueshme që të merr edhe një grua tjetër! Ndëra këta janë të detyruara t’ a pranojnë këtë situatë në të cilën gjenden, për arsye se ndonjëra nuk ka kujt t’ i drejtohet tjetërkujt, ndihet e pambrojtur dhe e pa ndihmë, thellë brenda saj ndoshta ekziston edhe bindja se me të vërtetë faji është si gjithmonë te ajo por pa e humbur asnjëherë shpresën. Dhe për këto arsye ajo duron shumë padrejtësi që i bëhen, duron edhe gruan tjetër të burrit të saj që është një gjë tepër e vështirë, ajo duron dhe vuan netë të tëra duke pritur të shoqin kur do shkoj te ajo, përderisa i shoqi kishte mundësi që të rrijë më shumë me gruan e tij të dytë. “ E ka mshelë derën me therra! Burrë mbas vetes nuk la. Por mirë kur do ai i madhi e leu mashkull bile . Ndonjiherë do të bahet ai pronar i kësaj shtëpie! (Aliu, 2001:209).

Vajza nuk vlerësohet aq sa duhet për të mos thënë aspak në rolin e vazhdimësisë së fisit apo brezit në familje, gjithmonë është ajo ideja se vetëm femiu me gjini mashkullore është kryesor sa i përket kësaj çështjeje. Si pronar shtëpie kurrë nuk konsiderohej gruaja, e nëse në një shtëpi nuk ka mashkull atë shtëpi e quanin pa të zot! “ S’deshti me u martue e këndej luen bishtin me Imerin; natë e ditë me te. A mund të

rrijë vejusha pa burrë ej? Prej nja dy tri ditësh derisa ta harrojë të parin e mandej grahi me të tjerët!(Aliu, 2001: 221).

Një gjë tjetër e neveritshme e shpifëse që e vë femrën thënë më mirë një vejushë, janë thashethemet që shpikin njerëzit ndjellakeq që sajajnë mijëra e mijëra gjëra për gruan që sapo i kishte vdekur i shoqi.. Që nga ai moment ajo duhet të ketë shumë kujdes sesi sillet, si vishet, me kë flet, si flet e në ç'mënyrë e jo më të merrte dikë si punonjës apo ndihmës në shtëpinë e saj. “E vetmja brengë, të cilën nuk mund ta shlyente kurrsesi qe Aliu “ (Aliu A., 2001: 226).

Ndër pozitat më të vështira që ndodhet një grua është roli i saj si nënë, e aq më vështirë kur është e detyruar të jetojë ndaras nga i biri. Edhe pse të ndarë, nëna assesi nuk e harron fytyrën aq të dashur e ëngjëllore që kishte parë në momentin e fundit mu para pak çastesh nga ndarja. Ajo fytyrë nuk i hiqet gjatë gjithë jetës, me shpresën se do ta shohë përsëri një ditë, kjo brengë ia bren shpirtin tërë kohës ...“Tash edhe po ta shihte të birin, me siguri nuk do ta njihte më e ëma nuk do ta njihte të birin! Nëna të mos e njohë të birin!”. Është jashtëzakonisht e dhembshme që një nënë të mos e shohë me vite me radhë fëmijën e saj, duke mos ditur asgjë mbi të, se nga është, a është rritur, a është shëndoshë, mos ndoshta i kishte ndodh diçka ..“Mendonte se i biri do ta parafytyrojë tash vetëm si një grua shpirtligë, të shëmtuar dhe shtrigë, që nuk ka fije dashurie ndaj të birit, të cilën e urrente për ç'arsye e ka lënë atë jetim, për arsye se e ëma ishte martuar me tjetërkend.

Romanin që kap mori fill diku në Gollak, me një vashë të bukur që ende nuk e ka ndjerë kënaqësinë e jetës e cila vijon ndaj një femre orëprerë (Aliu, 2001:226/227).

Është jashtëzakonisht e dhembshme që një nënë të mos e shohë me vite me radhë fëmijën e saj, duke mos ditur asgjë mbi të, se nga është, a është rritur, a është shëndoshë, mos ndoshta i kishte ndodh diçka ..“Mendonte se i biri do ta parafytyrojë tash vetëm si një grua shpirtligë, të shëmtuar dhe shtrigë, që nuk ka fije dashurie ndaj të birit, të cilën e urrente për ç'arsye e ka lënë atë jetim, për arsye se e ëma ishte martuar me tjetërkend “. “Romanin që mori fill diku në Gollak, me një vashë të bukur që ende nuk e ka ndjerë kënaqësinë e jetës e cila vijon ndaj një femre orëprerë (Aliu, 2001:227/228).

Me pak thënie pikëzohen pa asnjë dyshim jeta e një gruaje, duke filluar qysh prej asaj vashe të bukur me fytyrë të çiltër, mandej në një grua panafakë, fatkeqe dhe mjaft e mbyllur në vetvete duke menduar ndoshta vallë se çfarë! Gjithmon e zhytur në mendime për djalin që i është rritur, duke thënë në vetvete: Mos ndoshta vdes edhe unë e nuk po e pres.. Ma mire ta martoj gjersa jam vetë... kësaj vere ma!“ (Aliu, 2001: fq. 226).

Mbas tërë këtyre lëngimeve në të cilat mbase secila femër ka ecur përgjatë ekzistencës së vet, ajo sikurse gjësendin më të dashur e cila e mirëpret gjatë jetesës gjë e cila do ishte që të jetojë e shijoj ditën dhe çastin e bukur kur i biri do bënte martesë, kur do t'a vështronte atë me

kostume të bukura si dhëndër karshi resë së djalit e cila i dukej se ishte më e bukur prej të gjithave!

Mbase në këtë çast teksa shikonte atë paraqitje gjykonte se ia ka arritur pikësynimit, djali ishte bërë burrë nga shkak që ajo se ka sakrifikuar jetën e saj pa ndonjë qëllim të caktuar gjër më sot. “... As që je jo, As që je sikurse të gjitha femrat!... Ato s'e kishin lanë veçse me një... Ishin mjaft e ti ma mbylle derën veçse me një, ndërsa ai ishte, ku ndodhet sot?... Përse edhe ti s'mi bane nja pesë a gjashtë, për të mbushur kullën e këtillë” (Aliu A. 2001:226).

Është jashtëzakonisht e dhembshme që një nënë të mos e shikojë me motmote të tëra fëmijën e vet, duke mos ditur asgjë mbi të, se nga është, a është rritur, a është shëndoshë, mos ndoshta i kishte ndodh diçka .. “Mendonte që i biri do të paramendoj tani thjeshtë sikur një femër zemërkeqe, e shpërfytyruar dhe plakë të shëmtuar, që nuk ka fije dashurie ndaj birit të saj, të cilin e përbuzte për ç'arsye e ka lënë atë jetim, për shkak se e ëma ishte martuar me ndonjë tjetër burrë“ (Aliu, 2001:226/227).

Romani i tij mori fill diku në Gollak, me një vashë të hijshme e cila akoma s'e ka ndjerë kënaqësinë e jetës e cila vijonte ndaj një femre orëprerë. Duket jashtëzakonisht e dhembshme që një nënë nuk mundi ta takojë të bijën për shumë motmote, duke mos ditur asgjë mbi bijën e saj, ku gjendet ajo, a është mëkëmbur ndopak, a gëzon shëndet të mirë, mos ndoshta i kishte ndodh diçka ..“Përthelloheshte që edhe djali mund të imagjinonte tanimë thjesht pors i një femër zemërkeqe, e shpërfytyruar

dhe dhëmbëzezë, që nuk ka fije dashurie ndaj djalit të vet, që e mërziste për ç'arsye e ka lënë atë jetim, për arsye se e ëma ishte martuar me ndonjë tjetër“.

Femra është ajo e cila si krijesë njerëzore lindë foshnjë, mirëpo s'është ajo e cila vendos për voglushët e saj se çdo të bëj, pra nuk është vetëm në dorën e gruas. Mirëpo përkatësia gjinore e përkundërt nganjëherë një dëshmi të tillë as që e merr parasysh duke u orvatur sikurse çdoherë tërë përgjegjësinë t'ia hedhë femrës e cila është skeptike që oguri i saj të jetë i këtillë. Hajria qëndron e ngashënjyer me sythin e afruar në vrimën e derës gjithashtu as që ka gjasa t'i largohet asaj ngase atëherë as që do i shikonte më dy bijtë e saj, e tani lumturohej duke i shikuar me krahët e hedhur në qafë “ (Sopaj N., Jehona, nr. 5, f. 305).

Nuk ka asgjë më fatmirë dhe më të mirë kur një nënë të zbulojë njëherazi dy bijtë e kësaj prej armiqve shndërrohen në dashamirë! Meqë secila e pamirë ndërmjet këtyre përfundon e ata ofrojnë dorën e qetësimi ndërmjet byrazërve, përmes shikimit të kësaj vërehet njëlloj vezullimi i pakufishëm, njëfarë fatmirësie me vlerë shumë të madhe, njëfarë qetësimi i thellë në gjoks i cili e merakoste ndër motmote! “Saqë do të dëshironte, brenda kësaj kohe, të rrinin së bashku duke i rrëfyer çdo gjë nga e shkuara, t'i rrëfente mbi sevdanë e saj, e cila asnjëherë nuk e ka lënë rehat, për arsye se e ka ruajtur me shpresë gjatë ekzistencës së tij, për arsye se me mungesën e Aliut gjithashtu gjëllimi i dukej i pakuptimtë. Shumëherë Hajria kishte gjykuar se gjëllinte vetëm për

Aliun, që të ndeshet gjithashtu së pari mbi këtë. Teksa kuptoi që arrijnë arabatë, Hajria nuk kishte gjasa të gjente hapësirë “ (Sopaj N., Jehona, nr. 5, f. 312). “Veprën rimanore e cila kap mori fill diku në Gollak, me një vashë që është e hijshme e cila akoma nuk e ka ndjerë kënaqësinë e jetës e cila vijon ndaj një femre orëprerë (Aliu A., 2001:226/277).

Duke dashur të gjejmë se cila prej këtyre fytyrave në veprat e N. Rrahmanit paraqet të vjetrën, pra botën e prapambetur (i ati edhe nëna) e cila të renë, atë përparimtarin (Hajria dhe Shehidja). Në rrëfimin e narratorit (personazhit) në vetën e parë, vërejmë se objekt trajtimi është vdekja e gjyshes Hajria. Natyrisht ky roman ka edhe një lidhje tjetër me romanin "Malësorja"? Duke i bërë një paralele të stilit këtyre romaneve, duket qartë se në fjalën e saj përfundimtare, veçanërisht para vdekjes së gjyshes Hajrija, ajo e shqipton fjalën "Kthehu"! Por tani shtrohet vetvetiu pyetja ku të kthefet? Prej nga të kthehet, ku dhe pse? Këtë rast na e kujton fare qartë vetë rrëfimtari kur flet për toposin apo (toponimin) Përroni i Keq? Për këtë arsye, personazhi kryesor Hajria sa herë që e përmend këtë topos mallëngjehet? Një plagë tjetër e rëndë është pa dyshim dhuna jugosllave dhe serbe e dëbimit të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, prandaj autori e realizon artistikisht këtë temë që është tmerruese për banorët shqiptarë...Te romani "Toka e përgjakur" krijimet kësodore të prozës rrëfimtare, në të cilat pikëzohen veprime të ngatërruara të ekzistencës së njëlloj morie pjesësh të shkëputura të cilat ofrojnë një rrjedhë që llogariten si vepra prozaike. Tek veprat e këtilla



janë të pranishme një mori individualitetesh, në risqet dhe interesat e të cilëve në këtë roman përsosen hollësisht me të tëra kontradiktat, veçanërisht tek përshkrimi i personazhit të Jusuf Lahit, sidomos në çastet dhe gjatë ditëve kur ishte duke ndenjtur aq i thelluar dhe zhytur në mendime..?

Mund të thuhet lirisht se letërsia që shkruan Nazmi Rrahmani është e angazhuar në kuptimin e mirë të fjalës, angazhim me sens të humanizmit dhe të marrëdhënieve mes njerëzve. Për pozicionimin e shkrimtarit ndaj realitetit, për vizionin e tij jetësor dhe filozofik, vlen të sjellim një mendim nga studimi monografik i Sabri Hamitit: "... realiteti është edhe jashtë nesh edhe në ne. Lidhur me qëndrimin e këtij romancierit përball së vërtetës, lidhur me vegimin jetik apo mendimtar, lypset të paraqesim një pikëpamje të shqyrtimit të Sabri Hamitit që trajton një temë të veçantë: "... e vërteta qëndron gjithashtu përtej neve, sidomos brenda nesh. Për pozicionimin e shkrimtarit ndaj realitetit, për vizionin e tij jetësor dhe filozofik, vlen të sjellim një mendim nga studimi monografik i Sabri Hamitit: "... realiteti është edhe jashtë nesh edhe në ne. Ai ekziston në vetëdijen e njeriut të vetëm në formën e njëmendësisë, në formën sa njeriu mund ta njohë". Në veprën letrare, në roman, kjo shkallë e përngjasimit me realitetin, nuk mbetet në nivelin e njohjes, por merr një trajtë më individuale, subjektive dhe manifestohet si qëndrim i individit. Duke u menduar t'i shmangët këtij subjektivizmi, Nazmi Rrahmani i gërsheton ngjarjet dhe përfytyrimin qenësor në

romanin e tij brenda një boshti themelor, personazhit, të cilin e vendos në një mjedis të caktuar jetësor.

Pikërisht nga ky kontekst tërësor i realitetit, autori nxjerr personazhe që përputhen plotësisht me perspektivën e zërit autorial të tekstit.

Zotimi dhe pajtimi i Nazmi Rrahmanit në këtë mënyrë mbështetet në tërë fushat e njohurive dhe dijeve rrëfyese, sikurse në seleksionimin e ndodhisë së përgjithshme, në radhitjen sipas radhës kohore të ngjarjeve, në shfaqjen dhe paraqitjen e ambientit, në quajtjen dhe pagëzimin e figurave dhe emërtimet gjeografike, në ndërmjetësimin e figurave historike dhe nacionale.

## P ë r m b l e d h j e

Ky studim hulumtues shkencor ka për objekt shqyrtimi letrare pozitën dhe fatin e gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit. Shkrimtari duke qenë i shtyrë nga ky motiv u jep personazheve vendin e merituar dhe të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare, sidomos kur ata ndjehen të pasigurta, të kërcënuara dhe të pambrojtura. Personazhet në veprat e Rrahmanit nuk e duan dhe nuk e meritojnë këtë mënyrë të jetesës, por fati i sjell në pozita inferiore dhe nuk kanë nga t'ia mbajnë, e vetmja gjë është t'u nënshtrohen fateve që ua sjell jeta dhe rrethi shoqëror. Shkrimtari i kushton rëndësi çdo gjëje që e përjeton femra, duke e paraqitur rolin e tyre vendimtar në të gjitha fushat e jetës. Në veprat e këtij shkrimtari femrat paraqiten kaheerë si qenie shumë të dhembshme, sepse këta janë mbartëse të dhembjeve të mëdha jetësore. Çdo personalitet i femrës shfaqet në atë mënyrë siç është, me problemet intime, psikologjike e shpirtërore. Një tipar kryesor në veprat e tij është pamja e grave në sytë e meshkujve dhe në mbarë rrethin shoqëror, të cilat me cilësitë e tyre karakteristike biejnë shumë shpejt në sy, gjë që përmes këtyre tipareve mund t'i dallojmë se çfarë roli luajnë këta në romanet e tij.

Ky shkrimtar e përshkruan në mënyrë të hollësishme dhe të gjithanshme pamjen e gruas, ku çdo lexues serioz dhe i mirëfillt i veprave të tij shumë lehtë mund ta zbulojë karakterin e saj. Përshkrimi i pamjes së saj i përshtatet personalitetit femëror me hijeshinë shpirtërore që ka, sepse kjo është një magji që të magjeps dhe të mbanë peng.

## **S u m m a r y**

This scientific research study aims to analyze in a literary aspect the position and fate of women in the works of Nazmi Rahman. The writer driven by this motive provides the characters with a rightful and important place in the Albanian society, especially when they feel insecure, threatened and unprotected. The characters in the Rahman's novels do not want and deserve this way of living, but destiny brings them to inferior positions and they do not have a way out, the only thing is to accept their destiny brought by life and society. The author pays attention to each thing that women experience, by presenting their crucial role in every aspect of life. Each personality of women is presented as it is, with their intimate, psychological and spiritual problems. One of the main attributes in his works is women's appearance in men's eyes and in the wide social circle, which with their characteristic features are eye catchy, and through these features we can tell what role women play in his novels. This author describes detailly and overall the women's appearance, where every serious and authentic reader of his novels might easily reveal her personality. The description of her appearance fits the feminine personality with the inner beauty she possesses, because she is a magic that fascinates you and makes you a hostage.

## А б с т р а к т

Ова истражување научно проучување на книжевните позиција анализа објектот и за судбината на жените во работата Назми Rrahmanit.Shkrimtari управувано од овој мотив му дава на карактери заслужено и важно место на албанското општество, особено кога тие се чувствуваат несигурни, загрозени и ранливи . Ликовите во делата Рахмани не сакаше и не заслужуваат овој начин на живот, но судбината носи во инфериорна позиција и немаат излез, единственото нешто е да се подложат на судбината која ја донесе живот и социјален круг. писателот обрнува внимание на она што искуствата на жените, презентирајќи ги своите клучна улога во сите области на jetës.Në работи на овој писател жени се чини одамна, како да бидат многу болни, бидејќи тие се носат големи болки jetësore.Çdo личноста на жената е прикажана како што е, со интимни проблеми, психолошки и духовно. Една од главните обележја на неговите дела е изгледот на жените во очите на мажите и на целиот општествен круг, кои со нивните карактеристични квалитети брзо паѓаат во очите, што ги надминува карактеристиките што може да ги открие какви улоги играат во романите неговиот. Писателот опишува во детали и севкупниот изглед на жената, каде што секој читател сериозни и значајни од неговите дела може лесно да го открие својот карактер. Описот на својот изглед одговара на женска личност со духовна убавина тоа, бидејќи тоа е магија која фасцинира и прави хипотека.

## Literatura e shfrytëzuar

Aliu Ali, Sinani Shaban, Çapaliku Stefan, Çobani Tonin, Letërsia bashkëkohore shqiptare, Alb-Ass, Tiranë-Tetovë 2001

Aliu, Ali, “Kërkime”, “Shtypshkronja 8 Nëntori”, Tiranë, 1990.

Bruqi Flori: Jeta dhe vepra : Nazmi Rrahmani, 2012

Çapriqi Basri, *Mikrostruktura e tekstit*, Rilindja, Prishtinë 1990

Dado, Floresha, Intuitë dhe vetëdije kritike, Onufri, Tiranë, 2006.

Gashi Osman, *Kufijtë e letërsisë*, Prishtinë 2008

Hamiti, Sabri "A-Zh romanet e Nazmi Rrahmanit", Rilindja, Prishtinë, 1982.

Hamiti, Sabri, Vetëdija letrare, Rilindja, Prishtinë, 1989.

Hamiti, Sabri, Letërsia moderne shqiptare, Albas, Tiranë, 2000

Hamiti, Sabri, Letërsia moderne shqipe. Tiranë, UET Press, 2008

Hysa Mahmud, *Hyrje në letërsinë shqiptare*, Prishtinë 2000

Islamaj, Sh. (2004) *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës

Ismajli Rexhep, *Shenjë e ide*, Rilindja, Prishtinë, 1974

Qosja Rexhep, *Dialogje me shkrimtarë*, Rilindja, Prishtinë, 1968.

Qosja Rexhep, *Shkrimtarë dhe periudha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975.

Qosja Rexhep, *Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006

Ramadani Kujtim, *Letërsia bashkëkohore*, Alb-Ass, Tiranë-Tetovë 2006

Rugova I., Hamiti S., *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1979

Rugova, Ibrahim, *Refuzimi estetik*, Rilindja, Prishtinë, 1987

Rrahmani, Zejnullah: "Teoria e mitit", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006.

Rrahmani Nazmi "Malësorja", 1965.

Rrahmani Nazmi " Pas vdekjes" (Kthimi i njeriut të vdekur), 1975.

Rrahmani Nazmi "Tymi i votrës së fikur", 1969.

Rrahmani Nazmi "Toka e përgjakur " Toka e përgjakur", I, II, 1973.

Rrahmani Nazmi "Rruga e shtëpisë sime", 1978.

*Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare*, Akademia e Shkencave dhe arteve të Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2005

Sopaj, Nehas "Rrëfimi klasit ose monologu si sekuencë gjuhësore", Jehona, nr.5,1995.



Shala Kujtim M., *Shekulli i letërsisë shqipe*, 2006

Shita, Vehap, *Gjurmave të letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

Shkurtaç, Gj. (2009) *Pesha e Fjalës Shqipe*. Tiranë: UFO University Press.

Tahiri Lindita, *Monologu personazhi dhe autori*, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2006

Zajmi Abdulla, *Vuajtjet shpirtërore të Hajrisë, (Përmendorja e fjalës)*, 1979

## **Deklarata e autorësisë**

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se kjo tezë e magistraturës përfaqëson punën time origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë, nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve. Studimi i kësaj teme është shkruar prej meje, nuk është prezentuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## V ë r t e t i m

Kandidatja Lulzana Aliti dorëzoi për redaktim gjuhësor temën e saj të magjistraturës me titull: Pozita dhe fati i gruas në veprat e Nazmi Rrahmanit. Tema e saj iu nënshtrua shqyrtimit dhe redaktimit të përgjithshëm gjuhësor. Andaj kemi bindjen se ky studim letrar është në përputhje të plotë me kriteret gjuhësore dhe standardin drejtshkrimor të gjuhës shqipe.

Profesor Thimi Nesti